



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

RAPORT

**Veprimtaria e Këshillit të Qarkut Shkodër
për vitin 2008**

DHJETOR, 2008

HYRJE

Raporti i Veprimtarisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2008 ka për objekt;

- ✚ Veprimtarinë e Këshillit të Qarkut Shkodër në tërësi, ku pasqyrohen veprimet konkrete të organeve ekzekutive të Këshillit të Qarkut, për realizimin e kompetencave ligjore, duke evidentuar jo vetëm detyrat e përmbushura, por dhe problemet që kanë lindur në përmbushjen e funksionit kushtetues dhe ligjor të Këshillit të Qarkut Shkodër.
- ✚ Veprimtarinë e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, ku pasqyrohen detyrat e realizuara të çdo drejtorie dhe sektori, në bazë të kompetencave ligjore, planeve mujore dhe detyrave javore me shkrim të ngarkuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

SHKURTIME EMËRTIMESH

KQSH	Këshilli i Qarkut Shkodër
SNZHR	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal
BE	Bashkimi European
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
MSA	Marrëveshja e Stabilizim -Asocimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,
SPT	Sekretariati i Përbashkët Teknik
KRRR	Këshilli i Rregullimit të Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
AFP	Arsimi i Formimit Profesional
TA	Të ardhurat
SAMT	Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës
IMT	Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës
ZRRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
AKKP	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave
ISHMT	Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës
KMT	Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (qark)
IC	Inter Cooperation (kooperimi zvicerian)

GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
SNV	Organizata Hollandeze për Zhvillim
ADA	Agjencia e Zhvillimit Austriak
TEULEDA	Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
UCOPED	Shoqata “Bashkimi për bashkëpunimin dhe zhvillimin e popujve”
PNUD	Programi për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara
SDC	Agjencia zviceriane për bashkëpunim dhe zhvillim
LAG	Grupi i Veprimit Lokal
IPA	Instrumentat e Para Aderimit
CAFOD	Agjencia katolike për zhvillim për vendet e Europës Lindore
OXFAM	Shoqata angleze për zhvillimin rural
VIS COL’ OR	Shoqata italiane për zhvillim
ËET SYS B	Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të lagta shqiptare
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
The Door	OJF për çështjet sociale

Baza ligjore e Veprimit të Këshillit të Qarkut

- Ligji nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligji nr. 8379 datë 29.7.1998 “Për buxhetin e Shtetit në Republikën e Shqipërisë”
- Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2008 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008” të Ministrisë së Financave
- Udhëzimi nr.258 dt 15.02.2008”Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008” të Ministrisë së Brendshme
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar
- Ligji nr 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”
- Ligji nr. 8607, datë 27.04.2000”Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar
- Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
- VKM nr.563, datë 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”
- Ligji nr. 8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”

- Vendimi Nr. 352 datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë/bashki”
- Ligjit 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”
- Vendimit nr 80 datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”
- Ligji Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”
- Ligji nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar;
- Ligji nr.8402, 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ”;
- Ligji nr.9780, datë16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”
- Ligji nr.9482, datë 03.04.2006”Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”
- Vendimet e Këshillit të Qarkut .
- Vendimet e Komisionit të Mbrojtjes së Tokës (KMT) në qark
- Vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit

Shënim: Për efekt të mospërsëritjes së shpeshtë të ligjeve dhe akteve nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtrohet Veprimtaria e Këshillit të Qarkut Shkodër, gjatë shkruarjes së raportit është përdorur termi i përgjithshëm “kompetencë ligjore” dhe nuk janë referuar ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

1.VEPRIMTARIA E KESHILLIT TE QARKUT NE TERESI

1. Kontradikta: kompetenca të kufizuara ligjore e financiare dhe roli i qarkut sipas orientimeve të BE

Veprimtaria e KQSH gjatë vitit 2008 është përballur me dy realitete:

- funksionin kushtetues “*Qarku* është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikat shtetërore.*”¹ dhe pamundësitë financiare dhe kufizimeve ligjore, që e pengojnë Këshillin e Qarkut të ushtrojë këtë funksion
- realitetin e ri, akoma të pakristalizuar, lidhur me vizionin e zhvillimit të qarkut sipas standarteve të BE.

• Këshilli i Qarkut

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 110

a. Duhet theksuar se edhe kompetenca kushtetuese si edhe ato ligjore, lidhur me veprimtarinë e KQ janë të përgjithshme, për më tepër mungon një ligj i veçantë për KQ e për rrjedhojë mungojnë detyrimet dhe te drejtat të shprehura në mënyrë explicite lidhur me marrëdhëniet e Këshillit të Qarkut me komunat dhe bashkitë.

Psh, po marrim një nga detyrat, jo pak të rëndësishëm, që ka KQ, atë të koordinimit. Informacioni i veprimtarisë së komunave mungon, shpesh i vonuar ose është i kufizuar, kështu me shumë vështirësi arrihet të përditësohen të dhënat statistikore që disponon KQ. Psh asnjë e dhënë nuk na është sjellë nga komunat e Dukagjinit, megjithëse kemi shpërndar një pyetsor disa muaj më parë. Jemi të detyruar që këto të dhëna i marrim në rrugë të terthortë. KQ nuk ka asnjë kompetencë ligjore për të monitoruar drejtpërdrejt veprimtarinë e komunave dhe bashkive. Ky informacion periodik, nuk është qëllim në vetvehte, por kërkohet në funksion:

- të njohjes së problemeve dhe pengesave, me qëllim ofrimin e bashkëpunimit për zgjidhjen e tyre,
- të njohjes së punës, arritjeve të qeverisjes së mirë, me qëllim të përcjelljes së eksperiencave të mira edhe në njësitë e tjera vendore, duke koordinuar bashkëpunimin e tyre,
- përcaktimit sa më të saktë të indeksit të zhvillimit social -ekonomik, indikatorit për nivelin e varfërisë, për nivelin e papunësisë, të ardhurat lokale, niveli i arsimimit të detyrueshëm, në mënyrë që të kryhen analiza, kërkime shkencore.
- hartimit të planeve të veprimit për zhvillimin e komunave dhe bashkive më pak të favorizuara.

b. Realiteti aktual është në përballje me një *realitet të ri* të pakristalizuar ende ose më mirë hipotetik, lidhur me vizionin e zhvillimit të qarkut sipas standarteve të BE. Ky realitet, që nga disa kryetarë komunash dhe bashkish është konstatuar drejtpërdrejt gjatë tureve studimore jashtë shteti, kërkon angazhim dhe rritje të kapaciteteve të Këshillit të Qarkut për të ushtruar rolin kushtetues, funksionet ligjore në kuadër të decentralizimit, për një shërbim shumë më cilësor e standart ndaj komunitetit. Funksionet e rajoneve (qarqeve) në vendet evropiane, janë të percaktuara qartë në dokumenta themelore dhe në aktet ligjore dhe nënligjore. Me kompetenca të percaktuara qartë dhe me një buxhet të mjaftueshëm ato lozin me të vertetë rolin, për të cilin janë krijuar: *zhvillimin rajonal në tërësi dhe komunave në veçanti si dhe vendosjen e standarteve rajonale*

të shërbimeve dhe ndërtimeve. Heret ose vonë edhe vendi ynë do të ketë ndryshime në ndarjen administrative dhe në rolin e Këshillave të Qarqeve (rajoneve) duke nisur që nga zgjedhja e drejtpërdrejtë e tyre nga banorët.

2. Veprimtaritë e kryera.

Administra e KQSH është përpjekur të kryej detyrat e veta, në përputhje me realitetin aktual, por edhe detyra, që mendojmë se ajo do t'i ketë në të ardhmen. Kështu psh, për përballimin e përgjegjësive të reja të KQ bazuar në V.K.M. nr.773, datë 14.11.2007 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal, për periudhën 2008-2013" , gjatë vitit 2008 , në KQSH, janë ndërmarrë disa veprime konkrete.

- Është ndërtuar struktura e re administratës së KQSH, sipas ligjit VKM -ve për Shërbimin Civil dhe në funksion të përmirësimit të performancës së punës.
- KQSH, ka zhvilluar dy konferenca shkencore, në funksion të Programit të Zhvillimit të Zonave Jo të Favorizuara, me temë "Dukagjini në Fokus", meqenëse në qarkun Shkodër, Dukagjini është zona më e pafavorizuar për infrastrukturën rrugore dhe treguesit ekonomikë-socialë, megjithëse me resurse të shumta natyrore turistike.
- Eshtë hapur faqja e internetit e KQ, nëpërmjet të cilës, të gjithë përdoruesit e tij do të kenë mundësi të njohin vizionin e KQ për të ardhmën, strukturën e institucionit, të shohin punën që bëhet aty për koordinimin e veprimeve dhe hartimin e strategjive, me tendencë inkurajimin e zhvillimit të gjithanshëm të qarkut Shkodër.
- Jane organizuar tre takime të rëndësishme me donatorët për të sqaruar më mirë rolin e KQ në zhvillimin tërësorë rajonal dhe sektorial dhe për të koordinuar punën e donatorëve në ndihmesën që ato do t'i japin njësive të qeverisjes vendore
- Në mënyrë që të shfrytëzohen më mirë kapacitetet njërëzore, që veprojnë pranë administratës së KQ, në mënyrë që ato të përfshihen konkretisht në hartimin e strategjisë së zhvillimit të qarkut, punonjësit e administratës janë grupuar në disa komisione, si Komisioni i bujqësisë, Komisioni juridik, Komisioni ekonomik, Komisioni inxhnierëve.
- Sëbashku me Drejtorinë e Bujqësisë në qark është organizuar Konferenca për vreshtat "kallmet" si dhe Panairi i madh i prodhimeve bujqësore të pranverës 2008
- Gjithashtu, në përpjekjet për t'i paraprirë zhvillimeve në kuadrin e zbatimit të SNZHR janë ngritur:

- Grupi i hartimit të projekteve
- Grupi i vlerësimit të projekteve

Grupi i hartimit të projekteve ka një rol të rëndësishëm përse i takon përgjegjësi dhe ngarkesës së punës. Në këtë grup pune bëjnë pjesë specialistë nga të gjitha drejtoritë, që njohin shumë mirë gjuhë të huaja, programet e kompiuterit dhe që kanë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve. Grupi mbledhet tre here në javë për të diskutuar rreth problemeve, që lidhen me hartimin e projekteve në kuadrin e programeve të ndryshme, sidomos të IPA-së. Në ditët e para të dhjetorit anëtarët e këtij grupi morën pjesë në një seminar të suksesshëm lidhur me metodikën e hartimit të projekteve. *Grupi i vlerësimit të projekteve* përbëhet nga Drejtorë dhe specialistë me përvojë të gjatë. Ata janë njohur me përvojën e Këshillit të Qarkut Dibër, të asistuar nga SNV për administrimin e *fondit të besimit*, që mendojmë se do të zbatohet në të ardhmën edhe për qarkun tonë

Për një shfrytëzim sa më të mirë të potencialeve njerëzore i është dhënë përparësi:

- Menaxhimit të veprimtarisë së administratës nëpërmjet objektivave dhe detyrave javore të përcaktuara për çdo drejtori, sektor dhe individ nga Kryetari si dhe nga planet mujore të Drejtorive.
- Zhvillimit të karrierës mbi bazën e aftësive profesionale dhe eksperiencës.
- Pjesëmarrjes së administratës në veprimtari trajnuese lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Planifikimit dhe rishikimit të punës, në mënyrë periodike.
- Vlerësimit të performancës të çdo punonjësi, në përputhje me kërkesat e Statusit të nëpunësit civil, në bazë të detyrave të çdo individi.

3. Lidhur me decentralizimin.

Decentralizimi është transferim i autoritetit dhe përgjegjësi të funksioneve publike nga pushteti qendror në pushtetin vendor. Decentralizimi përfshin aspektin politik, aspektin administrativ dhe atë financiar. Transferimi, si forma më radikale e decentralizimit, nënkupton transferimin e autoritetit politik të shoqëruar me transferimin e përgjegjësi për administrimin e burimeve njerëzore, si dhe të resurseve financiare, të nevojshme në ushtrimin e këtij aktiviteti .

Natyrisht, sukcesi në zbatimin e Strategjisë së Decentralizimit, është i lidhur sëpari me përmirësimet në legjislacion në favor të KQ-ve, konkretisht është i nevojshëm:

- Hartimi dhe miratimi i një ligji të veçantë për Këshillat e Qarqeve, madje mund të duhet edhe ndonjë ndërhyrje në Kushtetutë.
- Hartimi i ligjeve, akteve të tjera nënligjore me karakter të rajonal dhe sektorial, si dhe i metodikave, udhëzimeve, standarteve me qëllim rregullimin ligjor të marrëdhënieve qark, komunë/bashki, institucione qendrore.
- Transferimi nga pushteti qendror i kompetencave lidhur me disa nga shërbimet rajonale, siç janë ato që lidhen me arsimin, shëndetësinë, shërbimet sociale etj.
- Futja në të ardhurat e Këshillave të Qarkut e tarifave që vijnë nga shërbimet që kryhen nga institucione të deleguara pranë KQ, vendosja me ligj e taksave të caktuara në nivel qarku etj.
- Përmirësimi i punës për rritjen e kapaciteteve menaxhuese të zgjedhurve në dy nivelet si dhe të administratës së bashkive, komunave dhe Këshillit të Qarkut.

Decentralizimi nuk duhet kuptuar si shkarkim i përgjegjësive , si një ndarje e pushtetit qendror me atë vendor. *Zhvillimi i vendit, progresi në të gjitha fushat e jetës, kërkojnë një qeverisje efektive, që vjen si rezultat i partneritetit dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve që implikohen. Autonomia duhet kuptuar dhe duhet të shërbejë për të ndërtuar në standarte të reja ndërveprimin në mes niveleve të ndryshme . Përfitimi i përvojës, marrja e mendimeve dhe këshillimeve, respektimi i akteve rregullatore, bashkëpunimi për përfitim reciprok, duke u përdorur drejt, nuk janë ndërhyrje në kompetencat dhe autonominë e bashkive dhe komunave. Përkundrazi, përdorimi i këtyre ndërveprimeve, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi në dobi të përballimit sa më mirë të problemeve, që marrin në funksion organet e qeverisjes vendore, janë tepër të domosdoshme për çdo periudhë dhe në çdo rrethanë por, sidomos në stadin aktual, kur transferimi i funksioneve në mënyrë të justifikuar , shoqërohet me rritjen e pandërprerë të aftësive menaxhuese si dhe të potencialeve të gjitha strukturave të shtetit . Në këtë kuptim Këshilli i Qarkut Shkodër, në marrëdhëniet me Komunat dhe Bashkitë, është udhëhequr nga dy parime të rëndësishme që burojnë nga ligjet në fuqi: **Respektimi i autonomisë** dhe mbështetja fort në **institucionin e marrëveshjes**.*

Si përfundim, pa një raport të drejtë ndërveprimi e bashkëpunimi me komunat dhe bashkitë e qarkut nuk mund të krijohen dhe zbatohen politikat rajonale, nuk mund të realizohet

funkcioni kushtetues i Këshillit të Qarkut për të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi të detyrueshme për qarkun.

Duke vështruar gjithshka që është realizuar nga KQSH për vitin 2008, mund të konstatojmë pika të forta dhe pika të dobëta.

Pika të forta

- V.K.M. nr.773, datë 14.11.2007 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajona, për periudhën 2008-2013)
- Plani Final Rajonal Shkodër- Lezhë (2005-2020) “Eptiza,Internacional grupo EP”.
- Bashkëpunimi me donatorët e huaj dhe institucionet qendrore për rolin e qarkut, në kushtet e integritit të vendit tonë në BE dhe në NATO
- Nje staf i përkushtuar dhe i përgatitur për të përballuar sfidat e reja

Pika të dobëta.

➤ Funkcionet kushtetuese dhe ligjore të Këshillit Qarkut nuk janë koordinuar me ligje dhe akte nënligjore për të rregulluar në mënyrë konkrete marëdhëniet qark, pushtet vendor dhe institucion qendror.

➤ Zbatimi i ligjit ekzistues ka rezultuar jo shumë efektiv në përmbushjen e përgjegjësive të Këshillit të Qarkut. Hartimi i politikave rajonale dhe aq më tepër zbatimi i politikave në komunat dhe bashkitë e qarkut, ka mbetur një përgjegjësi pothuaj e papërmbushur nga qarku në kushtet ekzistuese, si rezultat i raporteve jo shumë të qarta institucionale me njësitë vendore dhe institucionet qendrore.

➤ Burime financiare janë të pakta për të realizuar funksionet dhe kompetencat ligjore të KQ-së, për të realizuar projekte apo investime me grante konkurruese në një bashki apo komunë ose në disa prej tyre, për të rritur kapacitetet njerëzore për përmbushjen e sfidave të reja në hartimin dhe zbatimin e politikës rajonale të zhvillimit. Të ardhurat e KQ-së përbëhen kryesisht nga kontributet që bashkitë dhe komunat janë të detyruara ligjërisht (kjo nuk është shumë e qartë) të derdhin pranë KQ-së, kontribute të cilat zënë rreth 80% e të ardhurave të përgjithshme të Këshillit të Qarkut. Mirpo megjithë përpjekjet tona për zbatimin e Vendimeve të KQSH të viteve 2007 dhe 2008, shkresave të dërguara dhe kontakteve të herëpashershme, ende nuk ka përfunduar arkëtimi për vitin 2007. Gjendja paraqitet si vijon. Të gjitha njësitë vendore të rrethit Malësi e Madhe kanë arkëtuar kontributin për Qarkun . Nuk e kanë arkëtuar atë për vitin 2007:

Komuna Bushat , Bashkitë Pukë e Fushë Arrëz, Komuna Qelëz, Komuna Rrapë. Për vitin 2008, gjëndja paraqitet si vijon. Sipas shkresës së Ministrit të Financave, për vitin 2008 janë lidhur Akt-marrëveshjet me pothuajse të gjitha njesitë vendore të Qarkut tonë për pagesën e kontributit, duke përjashtuar: Komunat Bushat, Fierzë, Qafë Mali, Qerret, Qelëz, Rrape, si dhe Bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz. Në zbatim të Akt-marrëveshjeve të mësipërme janë arkëtuar të ardhurat nga kontributi i Qarkut e vitit 2008, gjithsej 8.639.960 leke, ku pjesën më të madhe e ka arkëtuar Bashkia Shkodër, 7.000.000 leke

Si përfundim, të ardhurat e mbetura nga viti 2007 për tu arkëtuar në vitin 2008 ishin 2.180 mijë lekë, aktualisht janë arkëtuar 1020 mijë lekë ose 47 % e tyre dhe të ardhurat e planifikuara të vitit 2008 ishin 8.940 mijë lekë, kurse arkëtimi i tyre 8.640 mijë lekë,ose 97 % e tyre.

4. Vizioni i përgjithshëm i zhvillimit të Qarkut është promovimi i parimeve kombëtare dhe evropiane të zhvillimit të qarkut, të cilat konsistojnë në prezantimin e mekanizmave të rinjë për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të nivelit qëndror dhe Këshillit të Qarkut, dhe këtij të fundit me komunat dhe bashkitë, të cilat do të krijojnë rezultate të arritshme për zhvillimin e qarkut, në harmoni me politikat shtetërore, si dhe në interes të komunitetit të bashkive dhe komunave të qarkut .

Në këtë kuptim Këshilli i Qarkut, duke u mbështetur në VKM për SNZHR-në, në pritje të ligjit përkatës, që do të miratohet dhe në pritje të miratimit të ligjit të ri "Për qarqet", ligjit të ri për urbanistikën dhe në përputhje me rekomandimet e BE, do të punojë që të jetë:

- Qendër e mbledhjes dhe analizimit të dhënave të komunave dhe bashkive, dhe e vënies së tyre në shërbim të të gjithë atyre që hartojnë dhe zbatojnë projekte.
- Qëndër e hartimit të strategjisë së zhvillimit rajonal dhe sektorial dhe e zbatimit të saj në komuna dhe bashki.
- Qëndër e koordinimit të veprimeve ndërmjet donatorëve dhe përfituesve, komuna dhe bashki, për të patur një zhvillim të përgjithshëm dhe të mirëekuilibruar rajonal dhe sektorial
 - Qëndër e ngritjes së kapaciteteve lokale për të përballuar sfidat që kërkon bashkëpunimi me BE, për përfitim të fondeve të saj
 - Institucion që do të ndihmojë konkretisht komuna, me kapacitetet të pakta njerëzore, për të hartuar projekte në përputhje me standartet e BE-së.

- Vendi ku do të administrohet me kompetencë të plotë ligjore dhe morale i fondeve të pritshme, që përbëjnë atë buxhet që tashmë ka marrë emrin "fondi i besimit", fond nga i cili, nëpërmjet granteve konkurruese, do të përfitojnë të gjitha komunat e bashkitë aplikuese.
- Qëndër studimi i të gjitha akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për qeverisjen vendore, në mënyrë që të nxirren akte normative, rregullore me fuqi të detyrueshme në të gjithë qarkun e të zhvillohen veprimtari në interes të komunitetit të qarkut në përgjithësi dhe të komunave e bashkive në veçanti.
- Qëndër e promovimit të gjithshkaje të mirë të realizuar nga Këshilli i Qarkut dhe komunat dhe bashkitë, madje dhe nga individë të shquar

Për vetë konceptimin ligjor të sotëm të veprimtarisë së Këshillit të Qarkut, asnjë nga drejtimet e mësipërme të punës nuk mund të realizohet ashtu si duhet, pa një bashkëpunim të fortë ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe komunave e dhe bashkive, sipas parimit të *moscenimit të autonomisë dhe institucionit të marrëveshjes*. Madje marrëveshja është përcaktuese në këtë bashkëpunim.

2.VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS SË KQSH

2.1 ZYRA E MARRËDHËNIVE ME JASHTË

2.1.1 Bashkëpunimi me jashtë, prioritet i Këshillit të Qarkut Shkodër.

- Duke marrë parasysh se përmbushja e standarteve europiane për integrimin e Shqipërisë në BE dhe NATO, është e lidhur ngushtë me reduktimin e ç'ekuilibrave rajonalë, me kryerjen e reformës së decentralizimit, me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian, me rritjen e kapaciteteve të administratës publike për të përmbushur obligimet e Marrëveshjes së Stabilizim –Asocimit.
- Duke marrë parasysh angazhimet e qeverisë për përmbushjen e të gjitha prioriteteve të Partneritetit European, si dhe kryerjen e të gjitha reformave ligjore për përmbushjen e obligimeve të MSA.
- Duke marrë parasysh se vizioni i qeverisë për zhvillimin e qarqeve dhe zonave jo të favorizuara është elementi kyç i SKZHI dhe i integritit të Shqipërisë në BE dhe NATO.

- Duke marrë parasysh gatishmërinë e Komunitetit Europian për të dhënë një mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur për këtë gjithë instrumentet e disponueshëm të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare , ekonomike.
- Duke marrë parasysh se Këshilli i Qarkut ka një rol kushtetues të rëndësishëm për hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale në përputhje me strategjitë kombëtare, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,
marrëdhëniet me jashtë, kanë qenë prioritet i Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2008.

Këshilli i Qarkut Shkodër i ka kushtuar rëndësi të veçantë :

- Bashkëpunimit dhe zgjerimit e marrëdhënieve me organizmat europianë dhe euroatlantikë.
- Bashkëpunimit ndërkufitar, trans-kombëtar dhe inter-rajonat.
- Bashkëpunimit me vendet e rajonit, e veçanërisht me ato të Ballkanit Perëndimor, duke ju përmbajtur orientimeve për një rajon të stabilizuar dhe të siguritë, ku vendin e konflikteve ndëretnike e fetare ta zërë bashkëpunimi dy dhe shumëpalësh mes të gjitha vendeve të rajonit, duke qenë të ndërgjegjshëm se bashkëpunimi rajonal është parakusht për integrimin evropian dhe euro-atlantik të këtyre vendeve.

Objekti i Bashkëpunimit :

- Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare, që lidhen me zhvillimin e balancuar ekonomik në të gjithë rrethet e këtij qarku, nëpërmjet politikave nxitëse dhe tërheqjes së donatorëve dhe investitorëve të ndryshëm, të cilët mund të kontribuojnë konkretisht.
- Përfitimi nga asistencë teknike dhe financiare e organizmave europianë dhe ndërkombëtarë.

2.1.2. Drejtimet kryesore të Veprimtarisë së Marrëdhënieve me Jashtë për vitin 2008.

- ❖ Është shpallur këtë vit konkursi për vendet në Sekretariatit e Përbashkët Teknik (SPT) të Programit për bashkëpunimin ndërkufitar IPA CBC, Shqipëri-Mali i Zi të vendosur në Shkodër. Krahas saj është punuar me donatorë të ndryshëm, që kanë përfaqësi teknike prezente në vendin tonë dhe interesa të përbashkëta bashkëpunimi me qarqet, për zhvillimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve në drejtim.

- ❖ Me **GTZ** Këshilli i Qarkut ka realizuar një marrëveshje mbështetje për ngritjen e *Këshillit të Partneritetit dhe Agjencisë së Zhvillimit*. Me mbështetjen e GTZ janë krijuar forumet e partneritetit në tre rrethe dhe po mblidhen termat e referencës për hartimin e *Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut*, dhe do të vazhdojë puna për hartimin mbi bazën e tyre dhe të Planit Rajonal EPTIZA. GTZ jep konsulencën e vet në organizimin e takimeve me donatorët. Rezultat i këtyre takimeve ka qenë hartimi i *matricës* së bashkëpunimit, e cila ende nuk është miratuar nga të gjithë donatorët. GTZ ka hartuar një guidë turistike për Kelmendin dhe Thethin. Ka organizuar një vizitë studimore në Gjermani, Maqedoni, Rumani. Gjithashtu GTZ ka mbështetur një paraqitje të Këshillit të Qarkut në një panair në Laipzig.
- ❖ Me **SNV** Këshilli i Qarkut ka një marrëveshje për një studim fizibiliteti për nënshkrimin e një marrëveshje më të plotë, sidomos lidhur me ngritjen e kapaciteteve në administratën e KQSH për mundësinë e krijimit të Fondit të Besimit dhe administrimin e tij për grande konkurruese në komunat dhe bashkitë. SNV është partnere në Projektin “Parku Ballkanik i Paqes”. Ka organizuar një tur studimor në Dibër për *Fondin e Besimit*. Zyra e SNV është pranë Këshillit të Qarkut.
- ❖ Me **Intercooperation** Zviceran ka realizuar marrëveshje për Filmat “Dukagjini turistik”, për vënien e Administratës së Qarkut në rolin e vlerësuesit për projektin më të mirë 2008, si dhe për vlerësimin e Planeve strategjike të zhvillimit të 6 komunave dhe detyrat e projektimit për planet urbanistike të dy bashkive. Qarku është partner në *Komitetin drejtues të programit të Qeverisë zviceriane* dhe në *Komitetin e bashkëpunimit për realizimin e projekteve konkrete në bashkitë dhe komunat*. Ka organizuar një vizitë pune në Poloni. Filozofia e punës për këtë etapë të parë, që vazhdon deri në fund të vitit 2009, është bashkëpunimi i **Intercooperation** drejtpërdrejt me komunat dhe bashkitë. Brenda kësaj filozofie është përpjekur të rrisë bashkëpunimin me Këshillin e Qarkut, dhe është në përpjekje për të gjetur një bashkëpunim më frytdhënës me Këshillin e Qarkut.
- ❖ **ADA** (Agjencia e Zhvillimit Austriak), (në bashkëpunim me KfV) është një donatore shumë e rëndësishme në Qarkun e Shkodrës. Kontributi i saj, sidomos në qytetin e Shkodrës, ka qenë dhe është shumë i rëndësishëm. Sipas filozofisë së punës së saj, ajo ka ndërmarrë marrëveshje bashkëpunimi drejtpërdrejt me komunat dhe bashkitë. Për vitin 2008 pjesëmarrja e saj në takimet e donatorëve të zhvilluar në qark ka qenë e

vazhdueshme. Është në gjetje të një mënyre më të frytshme të bashkëpunimit me Këshillin e Qarkut.

- ❖ Në kuadrin e bashkëpunimit me Rajonin Molise (Itali), në të cilin është përfshirë si partner **TEULEDA**, kjo e fundit do të hapë një qendër të informimit turistik në Shirokë,
- ❖ Është organizuar në Shkodër takimi ndërkombëtar, Shqipëri - Mal Zi - Kosovë për Parkun e Paqes, në Bjeshkët e Namuna, ku ka marrë nismën një projekt i madh.
- ❖ Vizita në Campobasso, Regione Molise-Itali për disa projekte të përbashkëta bashkëpunimi, disa nga të cilat kanë startuar, disa të tjera do të përcaktohen në vizitën që do të bëjë një delegacion teknik i palës italiane në qarkun e Shkodrës parashikuar së shpejti.
- ❖ Është organizuar një tavolinë e rrumbullakët me shoqatat italiane VIS-Color për një ndërhyrje multi-disiplinore në komunat Shkrel dhe Kelmend me mbështetje të Cooperazione Italia. Në të njëjtën linjë për javën në vazhdim, po përgatitet dhe një tjetër ndërhyrje në zonën e Dukagjinit, por kësaj here me Shoqatën UCODEP.
- ❖ Vazhdojnë kontaktet me Euro Rajonin Adriatik dhe po punohet për pjesëmarrje në projektet që shtrihen në të gjithë ketë hapësirë të rëndësishme integruese.

Partneriteti në projekte

Këshilli i Qarkut Shkodër është partner në disa projekte me objekt :

- Ngritje kapacitetesh për administrimin në Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale me Këshillin e Qarkut, komunat dhe bashkitë (bashkëpunim me PNUD e organizma të tjerë ndërkombëtare).
- Mbështetje për lidhjen në një rrjet informatike të komunave dhe bashkive me Këshillin e Qarkut dhe për dixhitalizimin e disa shërbimeve.
- Mbështetje për krijimin e Fondit të Besimit dhe administrimin e tij si një qeveri e vogël, duke i paraprirë me kapacitete të formuara ndryshimeve të ardhme sipas orientimeve të BE.

2.1.3 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian, prioritet qeveritar dhe rajonal.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian prioritet qeveritar për integrimin në BE.Ky proces kërkon dhe angazhimin e Këshillit Qarkut Shkodër, në përmbushje të funksionit ligjor për hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale në përputhje me politikën kombëtare.

Në kushtet kur, përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian, është një nga synimet kryesore të MSA, është ngritur një grup pune, i përbërë nga specialistë, që njohin shumë mirë gjuhën angleze, për të përkthyer ligjin e qeverisjes vendore të disa vendeve europiane, ligjin mbi bazën e të cilit organizohen dhe funksionojnë institucionet e rajoneve, me qëllim që të analizohen ndryshimet dhe pikat e përbashkëta me ligjin shqiptar. Realizimi me sukses i këtij procesi kërkon bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integritimit, Kuvendin Popullor dhe grupet e interesit, në funksion të nxjerrjes së ligjeve dhe akteve nënligjore, që konkretizojnë kompetencat ligjore të KQSH, që rregullojnë marrëdhëniet e qarkut me komunat/bashkitë, si dhe institucionet qëndrore.

Zhvillimi i Qarkut Shkodër, kryerja e reformës së decentralizimit, forcimi i kapaciteteve administrative në përgatitjet për zbatimin e angazhimeve të MSA, hartimi i ligjeve funksionale sipas standarteve të BE, kusht themelor për integrimin e rajonit Shkodër dhe të Shqipërisë në BE dhe NATO, kusht themelor për përmbushjen e standarteve europiane.

2.2 DREJTORIA E PROGRAMIM-ZHVILLIMIT

Gjate vitit 2008 veprimtaria e Drejtorisë së Programim Zhvillimit ka patur këto drejtime kryesore pune, në zbatim të kompetencave ligjore, realizimeve sipas planeve mujore dhe detyrave të lëna nga Kryetari i Këshillit të Qarkut.



2.2.1 Sektori i Statistikës dhe Koordinimit

Sektori i Statistikës dhe Koordinimit në përmbushje të detyrës që ka ky sektor, ka realizuar mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioni për territorin, si bazë për mundësinë e objektivitetit në realizimin e materialeve të ndryshme strategjike dhe si mundësi e mëtejshme për monitorimin e realizimit të tyre nëpërmjet treguesve të ndryshëm, të vendosur sipas standarteve. Gjithashtu duke e konsideruar shpërndarjen e informacionit mbi territorin si marketing për nxitjen e interesit ndaj tij, gjatë vitit 2008 është bërë rifreskimi i të dhënave.

➤ Për këtë :

- Janë kontaktuar ose i është dërguar shkresë zyrtare të gjitha njësite vendore të Qarkut
- Janë freskuar të dhënat për popullsinë
- Për arsimin
- Për shëndetësinë
- Për biznesin
- Punësimin
- Bujqësinë, etj
- Është punuar për hedhjen në data baze të të dhënave që janë arritur të mblidhen

Të dhënat janë hedhur në të dy formatet, atë excel dhe access application.

- Eshtë azhurnuar database i organizatave joqeveritare.
- Eshtë bërë listimi i dokumentacionit strategjik në nivel kombëtar, rajonal e lokal.
- Janë përgatitur të dhënat për faqen e internetit.
- I është ofruar informacion bashkëpunëtorëve si ADA, SDC, IC, GTZ, SNV, MADA, Bashkisë Shkodër, Drejtorisë Arsimore, Medias, NGO-ve, Dhomës së Tregëtisë, Universitetit, etj

2.2.2 Sektori i Zhvillimit dhe i Turizmit, drejtimet kryesore të punës

Nxitja dhe koordinimi për hartimin e strategjive lokale të njësite të nivelit të parë të pushtetit vendor dhe bashkëpunimi me pushtetin qendror për realizimin e dokumenteve në nivel kombëtar është konkretizuar në angazhimin për:

➤ **Strategjia e Dukagjinit**

Hartimin e një materiali sa më të plotë bazë për hartimin e strategjisë së zonës së Dukagjinit. Qëllimi i hartimit të këtij materiali është krijimi i një baze për vendosjen e prioriteteve të

zhvillimit të zonës me synim ripërtëritjen ekonomike dhe ripopullimin e kësaj zone, duke i dhënë drejtim zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Për këtë qëllim :

- 1) është hartuar platforma e strategjisë
- 2) është krijuar grupi i punës i përbërë nga pjesëtarë të administratës dhe të jashtëm
- 3) janë përcaktuar temat sipas fushave të mundshme për zhvillim
- 4) janë përcaktuar personat përgjegjës dhe gjithësecili ka trajtuar temat sipas kërkesave të parashtruara nga grupi punës
- 5) janë zhvilluar 12 tema
- 6) është mbajtur konferenca “Dukagjini në fokus” Qershor 2008

Mbas mbajtjes me sukses të konferencës nga një grup pune më i gjerë se Drejtoria e Zhvillimit, janë organizuar takime me kryetaret e komunave dhe të fshatrave për të plotësuar nevojat dhe prioritetet për çdo komunitet të vogël, por me gjithë këmbënguljen tonë, asnjë nga përfaqësuesit nuk i është përgjigjur kërkesave për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, megjithëse nga ana jonë i është kërkuar disa herë.

➤ **Programi për zhvillimin lokal dhe decentralizimin**

Nëpërmjet “Programit për zhvillimin lokal dhe decentralizimin”, financuar nga kooperimi zviceran po bëhet i mundur realizimi i programeve të zhvillimit në 7 njësi të qeverisjes vendore. Është vazhduar aktiviteti në projektin “Programi për zhvillimin lokal dhe decentralizimin”, financuar nga kooperimi zviceran, implementuar nga Inter Cooperation. Për rrjedhojë 8 njësi të nivelit të parë të pushtetit vendor marrin asistencë për administrimin e pushtetit në kuadër të decentralizimit dhe të rritjes së kompetencave lokale. Konsiston në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe ka edhe projekte të fillimit të shpejtë (investime deri në 30000 euro për çdo njësi lokale).

- Gjatë vitit 2008 janë zhvilluar tre takime të Komitetit Koordinues Lokal
 - Mars 2008 në Koplik
 - Korrik 2008 në Pukë
 - Nëntor 2008 në Guri i Zi

Gjithashtu në Maj të vitit 2008 është zhvilluar një udhëtim studimor në Poloni. Grupi ishte i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Qarkut, të njëjstëve vendore pjesëmarrëse në programin e

zhvillimit rajonal dhe decentralizimit, përfaqësues të IC, përfaqësues të shoqatës së komunave dhe bashkive.

Qëllimi i udhëtimit:

- ❖ Njohja e funksionimit të pushtetit lokal të niveleve të ndryshme dhe marrëdhënia e tyre. Gjithashtu funksionimi i aplikimit të fondeve strukturore te EU dhe roli i pushtetit lokal ne këtë aspekt.

Në zbatim të “Programit për zhvillimin lokal dhe decentralizimin”, janë bërë analiza për çdo njësi vendore, janë nxjerre nevojat e ndërhyrjes për çdo njësi vendore, është përgatitur dhe kryer procedura për “Projektet e fillimit të shpejtë”, është bërë planifikimi për vitin 2009, janë përgatitur planet e zhvillimit për 6 njësi vendore, janë përgatitur planet urbanistike për dy njësi vendore, janë zhvilluar trajnime për administratën e këtyre njësive, etj

Për vitin 2008 vlerësimi i projekteve të fillimit të shpejtë nga ana e Këshillit të Qarkut, është bërë nga një grup punë i përbërë nga drejtorët e drejtorive dhe në bashkëpunim me përfaqësues të IC.

➤ **Rishikimi i Strategjisë së Qarkut Shkodër**

Duke u mbështetur në V.K.M. nr.773, datë 14.11.2007 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal , për periudhën 2008-2013” në vijimësi gjatë vitit 2008, Këshilli i Qarkut Shkodër mori iniciativën për paraprirjen e procesit që parashikon SNZHR. Gjatë punës për përgatitjen e këtij procesi u ofrua mbështetje teknike nga GTZ gjermane.

Veprimtaria për paraprirjen e procesit që parashikon SNZHR.

- Janë zhvilluar ëorkshope planifikuese në shkurt 2008 ku u diskutua mbi projektin e GTZ “Zhvillimi ekonomik dhe nxitja e punësimit në Veriun e Shqipërisë”, mbi mbështetjen e zhvillimit të një sistemi për planifikimin e integruar, dhe diskutimi i marrëveshjes mbi mbështetjen e këtij procesi nga GTZ.
- Në Mars 2008 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes Këshillit të Qarkut Shkodër dhe GTZ Gjermane. Objektivat e kësaj marrëveshje konsistojnë në mbështetjen nga ana e GTZ në hartimin e koncepteve paraprake të zhvillimit të bazuara në planet ekzistuese të zhvillimit (EPTISA), moderimi i procesit, mbështetje në zbatimin e dy projekteve pilot, mbështetje në krijimin e strukturave në bazë të SNZHR – së.

Theksojmë se në marrëveshje janë të përfshira edhe mundësitë për bashkëpunim me agjenci të tjera donatore.

- Në Prill 2008 është organizuar Ëorkshop mbi vendosjen e krijimit të grupeve të punës , forumit dhe n/forumeve.
- Në qershor 2008 është organizuar një takim për përgatitjen e procesit të zhvillimit rajonal në Qarkun Shkodër.
- Në qershor 2008 është zhvilluar një udhëtim studimor në Bavari, Gjermani. Qëllimi i udhëtimit ishte njohja me funksionimin e pushtetit vendor, roli dhe funksionimi i LAG (Grupet lokale te veprimit), menaxhimi i fondeve strukturore, niveli dhe funksionimi i ofrimit të shërbimeve të komunitetit , etj.
- Në Shtator - Tetor 2008, janë zhvilluar takimet e N/forumeve Koplík, Pukë e Shkodër.
- Në bashkëpunim me ekspertët e GTZ është krijuar dhe zhvilluar një matricë me dokumentet planifikuese ekzistuese.
- Është hartuar nga ana e ekspertëve të GTZ dhe diskutur nga ana jonë plani i veprimit deri në fundin e projektit.
- Gjatë procesit , në periudhën deri Tetor 2008, janë zhvilluar takime me ekspertë të pavarur, si dhe takim me shoqërinë civile, në të cilat janë shpjeguar synimet e sipërmarrjes dhe domosdoshmërinë e përfshirjes së tyre në proces.
- Në fund të Tetorit është marrë pjesë në takimin EUROREGIA, në Laipzig ku përveç paraqitjes së resurseve të qarkut janë realizuar dhe takime mbi funksionimin e pushteteve ne disa vande të rajonit, funksionimi i LAG në vendet perëndimore , etj.

Tani jemi në momentin e krijimit të database të burimeve njerëzore, që do të angazhohen në proces mbas krijimit të forumeve.

➤ **Koordinimi i aktiviteteve të agjencive dhe donatorëve në qarkun Shkodër**

Në kuadër të realizimit të koordinimit të aktiviteteve në territorin e qarkut Shkodër, me iniciativën e Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit Rajonal, është bërë e mundur përgatitja dhe realizimi i tre takimeve me agjenci dhe donatorë, që kanë angazhimet e tyre në qarkun Shkodër dhe që kanë treguar interes për bashkëpunime në kontekstin e zhvillimit rajonal.

Qëllimi kryesor i këtyre takimeve :

- ❖ Koordinimi me synim shmangien e mbivendosjeve dhe parashikimet e ndërhyrjeve të përbashkëta.

Takimi i Shkurtit 2008

Morën pjesë përfaqësues të Qarkut Shkodër, përfaqësues të zyrës së koordinimit Austriak, Tiranë, përfaqësues të kooperimit Italian, Tiranë, të kooperimit Zviceran, Tiranë, IC Shkodër, Zyra e GTZ Shqipëri, Ministria e Integrimit, përfaqësues i MADA, Tiranë, TEULEDA, Shkodër.

Qëllimi i Takimit.

- Paraqitja e prioriteteve që ka Qarku Shkodër në Zhvillimin Ekonomik, parë në fokusin e SNZHR, dhe të ndërthurura këto me projektet dhe objektivat e vëna nga Plani Final Rajonal Shkodër- Lezhë (2005-2020) "Eptiza,Internacional grupo EP".

Çështjet që u diskutuan në këtë takim :

- Diskutim mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rajonal dhe realizimi i saj ndërthurur me Planin e Zhvillimit Hapësinor EPTISA, të Qarkut Shkodër
- Diskutim mbi strukturat e reja që do të ngrihen pranë qarkut Shkodër sipas kësaj strategjie. (Agjensia e Zhvillimit të Qarkut. Këshilli i Partneritetit të Qarkut, etj)
- Njohja me platformën për hartimin e Planit të Zhvillimit të Dukagjinit
- Paraqitja e prioriteteve të Qarkut sipas sektorëve.

Takimi i Majit 2008

Qëllimi i takimit, çështjet që u diskutuan.

- U diskutua mbi projekt - propozimin mbi bashkëpunimin me Qarkun Shkodër, Agjencia Austriake për Zhvillim, ADA..
- Prezantim i planit të përgjithshëm të veprimit për bashkëpunimin me Qarkun Shkodër, GTZ.
- Prezantim i draft marrëveshjes së bashkëpunimi me Qarkun Shkodër, SNV.
- Prezantim i ecurisë së punës së organizatave të tjera prezentë ne Qarkun e Shkodrës.
- Diskutime nga të ftuarit, mbi prioritetet e ndërhyrjeve të deritanishme dhe planet në të ardhmen për bashkëpunimet me Qarkun Shkodër, nëpërmjet matricës së ndërhyrjeve realizuar nga Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Rajonal.

Morën pjesë përfaqësues të Qarkut Shkodër, IC, ADA, SNV, GTZ, TEULEDA.

Takimi i Korrikut 2008

Qëllimi i takimit, çështjet që u diskutuan.

- Ngritja e Trust Fund (fondi i besimit). Shprehja zyrtare e angazhimit.

- Ngritja e Fondit Special për blerjen e kapaciteteve dhe shërbimeve për hartimin e projekteve të mëdha dhe projekteve të llojit te vecantë. (Shembulli i parë, Financimi i procesit për hartimin e strategjisë së zhvillimit të zonës Dukagjinit).
- Strukturimi i ndihmës për realizimin e trainimeve të thella për FUNDRISING. (mbështetje financiare).
- Strukturimi i ndihmës për mbështetje për trainime dhe internship në marrëdhënie me IPA.
- Propozim për hartimin e një marrëveshje të përbashkët mbi ecurinë e mëtejshme, me pika konkrete, ndërmjet Qarkut Shkodër dhe përfaqësuesve të organizatave donatore dhe agjencisë të zhvillimit.

Turizmi, drejtimet kryesore të punës.

Në sektorin e turizmit janë evidentuar resurset me potencial turistik, natyrore, historike, etj, për të gjithë qarkun.

- Janë grumbulluar të dhëna për secilin rreth dhe janë paraqitur në faqen e internetit.
- Gjithashtu me mbështetjen e GTZ, është krijuar një grup pune i gjerë, ku bën pjesë edhe qarku. Ky grup do të ketë objektiv kryesor të punës evidentimin dhe krijimin e produkteve turistike, krijimin e paketave rajonale turistike dhe angazhimi në projekte të zhvillimit të turizmit.

Partneriteti në projekte

Njohja, ndjekja dhe partneriteti në projekte, që realizohen në territorin e Qarkut tonë, është konsideruar një nga pikat kryesore, e cila bën të mundur realizimin e disa objektivave të zhvillimit në fusha të ndryshme.

- Në këtë kuadër jemi në fazën e përfundimit të kontratave të procedurave të dy projekteve *INTERREG*, ku jemi të inkuadruar me fonde *CARDS-PHARE*.
- *INTERREG A- Italia*, ku jemi vetëm përfitues nga fonde të partnerëve italianë.
- Projekti NEPTUNE Mbi promovimin e integruar të territorit. (Qarku nuk përfiton fonde, por ka vetëm përfitime nga partnerët italianë.)
- Projekti ROSA "Realizimi i një rrjeti mes organizmave të zhvillimit lokal dhe të enteve të panairëve të Adriatikut".

Qëllimi i projektit : Njohja e mëtejshme e territorit të Qarkut Shkodër, nëpërmjet futjes edhe të institucionit tone në një rrjet, i cili promovon dhe përmirëson marketingun mbi

territor. Kjo duke pasur parasysh se në projekt janë shumë partnerë italiane me përvoja të konsolidura në fushën përkatëse dhe gjithashtu dhe partnere nga Ballkani.

Janë kryer këto veprimtari

- Analizë për territorin tonë në bazë të objektivave të projektit.
- Paraqitja e tyre në dokumente përfundimtare.
- Kërkime në fushën e temës së projektit.
- Hyrja në netëorkun e Adriatikut

Veprimtari në proces

- Përgatitja e një guide biznesi për bizneset e qarkut Shkodër.
- Katalog – Kalendar me bizneset e qarkut Shkodër

Projekti ËET Sys B

Objektivi i përgjithshëm i projektit :

- Ndërtimi i një skenari që përmbledh rregullat për mbikëqyrjen e gjendjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke ju përmbajtur parashikimeve të aksioneve në projekt, të destinuara për qarkun, ka zhvilluar disa aksione të natyrës së sensibilizimit mbi rrisqet që ekzistojnë dhe mundësinë e evitimit të tyre. Në veçanti është patur parasysh sensibilizimi mbi ruajtjen në gjendjen natyrale të brigjeve të Liqenit të Shkodrës dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm përgjatë këtyre brigjeve, që përkon dhe me stadin e mbrojtjes që ka kjo zonë. Në këtë kuadër:

- Me rastin e festës “Dita e Liqenit” në Shkodër janë organizuar aktivitete të ndryshme, fushata sensibilizimi, ëorkshope etj. Me këtë rast u angazhuam në prodhimin e disa posterave me foto dhe mesazhe të ndryshme me pamje nga liqeni. Në këto postera perforcehej idea e mbrojtjes së bukurive të natyrës, përdorimit të tyre në shërbim të komunitetit, ndërhyrjes për përmirësimin e dëmeve, ndalimin e ndërhyrjeve të paligjshme, etj. Posterat u shpërndanë në dy pika të rëndësishme të qytetit Shkodër dhe në Komunën Kastrat, komunë që shtrihet në buzë të liqenit.

- Gjithashtu në Qershor të këtij viti, kemi marrë pjesë në panairin e turizmit FAT.

Sipërfaqja e marrë në përdorim nga Qarku Shkodër u mendua si një pjesë e integruar edhe me

partnerë të tjerë lokalë si Bashkia Shkodër, Prefektura Shkodër dhe angjensia e zhvillimit “Teuleda”.

- Në tjetër aksion i kryer (në proces si rezultat i akordimit të fondit me 18 Nëntor 2008) është botimi i një materiali broshurë “*Rrisqet nga shpyllëzimi në brigjet e Liqenit Shkodër dhe nevojat*” ku paraqiten rrisqet nga shpyllëzimi në brigjet e Liqenit Shkodër dhe nevojat. Botimi është në proces.

Pavarsisht nga paqartësitë e fillimit, është përgatitur gjate procesit e gjithë procedura sipas kërkesave të projektit dhe ligjeve të shtetit shqiptar. Janë kryer dy përlllogaritje dhe jemi në proces të perlllogaritjes së fundit, është realizuar raporti sipas kërkesës së partnerit kryesues dhe është marrë pjesë në mbledhjen përfundimtare.

Në të dy këto projekte Qarku është financuar me një shumë prej 18 000 euro.

Projekti i GTZ “Bashkëpunimi ndërkuftar në rajonin e Liqenit të Shkodrës”.

Në këtë projekt Këshilli i Qarkut Shkodër ka përfaqësues në bordin këshillimor ndërkuftar.

Komunat, që përfitojnë nga ky projekt, janë Komunat Kastrat, Gruemirë dhe Bashkia Koplík

Objektivat e projektit:

- 1) Përmirësimi i kushteve të punës për një zhvillim të strukturuar ndërkuftar të rajonit të Liqenit të Shkodrës.
- 2) Përmirësimi i cilësisë së planifikimit lokal e rajonal dhe drejtimi i proceseve të zhvillimit brënda dhe ndërmjet komuniteteve në rajonin e Liqenit të Shkodrës.
- 3) Ofrimi i bazës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik (turistik) dhe ekologjik në rajon.

Gjithashtu në kontekstin e marketingut të territorit, janë realizuar panairë (Agrobiznes 2008, FAT, Laipçig, “Imazhi Shqiptar”). Panairë të realizuara nëpërmjet financimeve tona, por edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme. Janë botuar dhe prodhuar broshura “Dukagjini”, dokumentari “Dukagjini në fokus”, broshurë dhe kalendar për bizneset, broshurë për liqenin etj.

Përgatitja për projektet e IPA

Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, sipas detyrave të caktuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut, në kontekstin e realizimit të funksioneve të veta dhe ato të deleguara, është bashkëpunuar dhe kemi përgatitur relacione për zonat për të

cilat parashikohen projekte dhe ndërhyrje në infrastrukturë. Janë pregatitur projekt propozime bë fushën e turizmit dhe të shërbimeve sociale

Bashkëpunimi me organizma dhe donatorë vendas dhe të huaj .

Veprimtaria e organizmave të ndryshëm, vendas dhe të huaj, në territorin e Qarkut tonë është konsideruar si një nga faktorët e rëndësishëm për realizimin e disa objektivave dhe veprimtarive.

Janë mbajtur kontaktet me shumë NGO për veprimtaritë e tyre në qarkun tonë. Janë bërë takime pune me CAFOD, OXFAM, ADA, SDC, MADA, TEULEDA, SNV, etj organizma e donatorë për të ballafaquar prioritetet tona me veprimtarinë e tyre. Kjo me qëllim që ndërhyrjet e tyre të bëhen në vendin dhe kohën e duhur dhe gjithashtu të mënjanoen mbivendosjet e veprimtarive të tyre.

Trajnime për ngritjen e kapaciteteve.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve është marrë pjesë në trajnime ofruar nga INËENT dhe GTZ mbi marketimin rajonal dhe zhvillimin rajonal, në Gjermani dhe Mal të Zi. Gjithashtu me rëndësi ka qenë pjesmarrja në trajnime nacionale për IPA. Një përfaqësues i zyrës është në Bruksel për programin IPA dhe fondet e tjera strukturore.

Këto janë disa nga drejtimet më kryesore të punës së drejtorisë për vitin 2008.

Detyrat e kryera sipas planeve dhe detyrave të lëna nga Kryetari i KQSH.

- Është organizuar takimi i Komisionit për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit për Zonën e Dukagjinit. Është përcaktuar platforma ,struktura.
- Është pregatitur materiali për tre rrugët e Dukagjinit, Kelmendit, Hajmelit, me të dhënat përkatëse.
- Bashkëpunim në organizimin e Konferencës “Për shtimin e vreshtave të varietetit Kallmet”.
- Është organizuar takimi i përbashkët me donatorët e huaj për të paraqitur platformë- idenë e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, si dhe koordinimin e veprimtarisë së tyre.
- Është vazhduar të punohet për përgatitjen dhe sistemimin e materialeve për faqen e internetit të Qarkut.
- Ka vazhduar azhurnimi i dosjeve të njësive lokale me të dhënat e fundit të vitit 2007.
- Ka vazhduar studimi i materialeve të SNZHR dhe janë nxjerrë detyrat konkrete nga secili specialist.

- Është marrë pjesë në takimin e organizuar mbi projekt -propozimin në rrethin e Malësisë së Madhe nga ana e VIS COL' OR.
- Është punuar për organizimin e takimit të datës 13 dhe 14 mars 2008 për Parkun e Paqes në Ballkan. Është marrë pjesë në takimin mes aktorëve rajonalë, për hartimin e një plani pune "Për një program zhvillimi të qëndrueshëm të integruar ndërkufitar në zonën e Bjeshkëve te Namuna" në bashkëpunim me SNV, në datat 13 dhe 14 mars 2008
- Takim mbi Projektin Eet Sys B, për koordinimin me partnerët shkodranë për ndërhyrje të përbashkëta.
- Takimi i tretë dhe i katërt me grupin e punës për hartimin e strategjisë së Dukagjinit, në lidhje me detyrat që u caktuan në mbledhjen e fundit.
- Prgatitja e materialeve për internet.
- Azhornimi i veprimtarisë së shoqërisë civile.
- Të dhëna për ecurinë e turizmit në Qarkun Shkodër për vitin 2007.
- Detajimi i disa të dhënave për tu bërë në drejtim të turizmit për vitin 2008.
- Projekte në kuadër të IPA Adriatic .
- Material informues për projektet "Rosa" dhe "Neptun", pregatitja e dosjeve me të gjitha materialet. (Nuk ka informacion për ecurinë)
- Bashkëpunim në organizimin e Panairit "Agrobiznes 2008" .
- Është organizuar takimi i përbashkët me UCODEP dhe komunitat e Zonës së Dukagjinit, si dhe institucione të ndryshme.
- Është punuar për organizimin e takimit të datës 14.04.2008 me URI-in për problemet e fondeve të buxhetit me komunitat.
- Është pregatitur materiali për takimin e Kryetarit në Firence në bashkëpunim me z.Andrea Jakova, Këshilltar i Marëdhënieve me Jashtë.
- Është kontaktuar me komunitat e Qarkut për hartimin e listës të prioriteteve sipas komunave dhe bashkive.
- Konferenca e Dukagjinit.
- Materiali guide në bashkëpunim me GTZ .
- Është bërë redaktimi në shqip për përkthimin e guidës së Dukagjinit, dorëzuar për përkthim.

- Hartimi i një drafti, ku të përmbliidhen të gjitha rekomandimet e dhëna nga konferenca e Dukagjinit.
- Jane hartuar pyetsorët për kryetarët e fshatrave të Dukagjinit. Nuk është plotësuar asnjë nga ana e tyre.
- Takim me kryetarët e fshatrave dhe përfaqësues të komunitetit të Dukagjinit, për diskutimin e Hartimit të Strategjisë së Dukagjinit.
- Takim me donatorë për diskutimin e matricës dhe ardhmërinë e procesit, që do të zhvillohet në qark.
- Korrigjimi dhe redaktimi i temave të konferencës “ Dukagjini në Fokus”.
- Organizimi i një seminari me drejtorët e institucioneve, që kanë të drejtë të përfitojnë nga IPA.
- Takimi i komitetit koordinues të IC, Pukë, Guri i Zi. Përgatitja e një informacioni lidhur me planet e zhvillimit të komunave dhe bashkive, strategjitë e zhvillimit, projekte të gatshme etj.
- Hartimi i planit të aktiviteteve për hartimin e strategjisë së Dukagjinit (Nuk është kryer për arsye se nuk ka asnjë përgjigje nga fshatrat).
- Takim me përfaqësues të GTZ mbi përpunimin e planit të aktiviteteve dhe ecurinë e procesit të rishikimit të planeve ekzistuese, me bazë atë Eptiza, për hartimin e Strategjisë së Qarkut.
- Përgatitja e agjendës dhe materialit me përfaqësuesit e rajonit Molise (A.Jakova)
- Materiale narrative bazë për hartimin e masterplanit të Komunës Postribë, dorëzuar pranë Drejtorisë së Urbanistikës.
- Takim me përfaqësues të Ministrisë së Integritimit, në Tiranë mbi IPA.
- Përmirësimi dhe plotësimi i të dhënave në variantin Access application .
- Material - raport mbi gjëndjen dhe planin për të ardhmen në lidhje me implementimin e Projektit “Rosa” .
- Hartimi i materialit për takimin e shoqatës së qarqeve me temë : Kompetencat reale të Këshillit të Qarkut dhe roli i tij në të ardhmen.
- Takim me përfaqësues të GTZ, të bashkive dhe komunave të Rrethit Shkodër për ngritjen e nënforumit të rrethit , për hartimin e Strategjisë së Qarkut në bashkëpunim me GTZ
- Përgatitja e materialit informues për Qarkun Shkodër, sipas kërkesës së GTZ .
- Përkthimi i materialit të GTZ për Thethin.

- Pregatitja e materialeve promovuese për Eurorajonin 27-29 tetor 2008.
- Plotësimi i data base i burimeve njerëzore të përfaqësuesve të nën/forumeve Shkodër, Koplik, Pukë (në proces).
- Intervista për REC mbi disa pyetje në kuadër të projektit të GTZ “Bashkëpunimi Ndërkufitar në rajonin e Liqenit Shkodër”.
- Përfundimi i dokumentacionit të projektit ËET SYS “B” (në pritje të fondit).
- Ndjekja e punës mbi hartimin e Guidës për biznesin në qarkun Shkodër në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë, në proces.

Probleme të evidentuara.

Spektori i Statistikës dhe Koordinimit

- Mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit për territorin, në përgjithësi nuk është kryer sipas detyrave të lëna nga Kryetari gjatë muajve, sepse ka patur vonesa në marrjen e informacionit. Arsyeja kryesore është sepse asnjë njësi lokale apo drejtori që varet nga ministrite e linjes nuk sjellin informacion në mënyrë periodike. Informacioni është mbledhur nëpërmjet kërkesave me shkrim të herëpashershme nga ana jonë dhe kontaktimit direkt me to nëpërmjet takimeve të organizuara, apo nëpërmjet mbledhjeve të Këshillit të Qarkut. Si dobësi nga ana jonë është se, nuk kemi organizuar takime më të shpeshta pranë komunave me administratat e tyre, por kjo shpjegohet edhe me mungesa logjistike.

Spektori i Zhvillimit


- Mbas mbajtjes me sukses të konferencës, janë organizuar takime me kryetarët e komunave dhe të fshatrave për të plotësuar nevojat dhe prioritetet për çdo komunitet të vogël, por me gjithë këmbënguljen tonë dhe gadishmerine fillestare të të siperpermendurve, asnjë nga përfaqësuesit nuk i është përgjigjur kërkesave për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, megjithëse nga ana jonë i është kërkuar disa herë.
- Hartimi i planit të aktiviteteve për hartimin e strategjisë së Dukagjinit nuk është kryer, për arsye se nuk ka asnjë përgjigje nga fshatrat e kësaj zone. Jane hartuar pyetsorët për kryetarët e fshatrave të Dukagjinit. Nuk është plotësuar asnjë nga ana e tyre .
-

2.3 DREJTORIA E URBANISTIKËS

Drejtoria e Urbanistikës ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore, planeve mujore, Vendimeve të KRRT –së, duke koordinuar punën me KRRT-në e Qarkut, me komunitet dhe bashkitë, duke synuar;

- ✚ Miratimi i planeve strategjike, detyrave të projektimit, studimeve urbanistike, si dhe miratimi i lejeve të ndërtimit për investimeve publike dhe private në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
- ✚ Bashkërendimi i punës për hartimin e planeve strategjike, detyrës së projektimit të planit rajonal, të planit të përgjithshëm rregullues, të masterplaneve të zhvillimit territorial, të studimeve të pjesshme urbanistike, me njësitë e qeverisjes vendore dhe donatorët e huaj.
- ✚ Ndjenjë e lartë e shërbimit ndaj qytetarit.

Këshilli i Qarkut ka funksion të deleguar KRRT-në, e cila përmban struktura organizative që veprojnë pranë kësaj drejtorie. *Veprimtaria e Sekretarisë Teknike* Sekretaria Teknike e KRRT-së përbëhet nga Sektori i Projekteve dhe Sektori i Urbanistikës Ligjore.



- Sektori i Urbanistikës Ligjore shqyrton dokumentacionin nga ana ligjore, veçanërisht aspektet e pronësisë, të kontratave, përmbushjen e kërkesave ligjore nga investitorët publikë dhe privatë.
- Sektori i Projekteve shqyrton dokumentacionin nga ana kadastrale,

kontrollon projektet, si dhe paraqitjen hartografike të dokumentacionit. Në zbatim të detyrave të veta funksionale, Sekretaria Teknike e K.R.R.T.-së në koordinim me Këshillin Teknik dhe Këshillin e Rregullimit të Territorit, për vitin 2008 ka miratuar leje ndërtimi si më poshtë:

Investime strategjike në Qarkun Shkodër :

- Vendimi nr.7, datë 07.07.2008, Rinovim leje shesh ndërtimi dhe miratim leje ndërtimi për objektin “Linja 400 KV Tiranë – Podgoricë”. Zona e Qarkut Shkodër (verteksi A34-A20).
- Vendimi nr.11, datë 07.07.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin Rruga Shkodër –Hani i Hotit. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

- Vendimi nr.1, datë 04.09.2008, Miratim leje ndërtimi për “Rehabilitim i rrugës Vau Dejës-Nënshat”.

Detyra Projektimi, Studime Urbanistike

- Vendimi nr.1, datë 07.07.2008, Miratim detyrë projektimi për studim urbanistik zona Bushat.
 - Vijat e verdha të fshatrave
 - Studim urbanistik qendra Bushat
 - Studim zona industriale
- Vendimi nr.2, datë 07.07.2008, Miratim studimi urbanistik zona Bushat.
 - Vijat e verdha të fshatrave
 - Studim urbanistik qendra Bushat
 - Studim zona industriale
- Vendimi nr.7, datë 03.11.2008, Miratim i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Vau Dejës.
- Vendimi nr.8, datë 03.11.2008, Miratim i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Koplík.

Plane strategjike të miratuara në mbledhjen e K.RR.T.-së Qarkut , datë 03.11.2008.

- Vendimi nr.1, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Vau Dejës .
- Vendimi nr.2, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Koplík.
- Vendimi nr.3, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Pukë.
- Vendimi nr.4, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë Arrëz.
- Vendimi nr.5, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Gur i Zi.
- Vendimi nr.6, Miratim i Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç.

Sekretaria Teknike e K.RR.T.së, Këshilli Teknik dhe K.RR.T.ja e Qarkut , në zbatim të marrëveshjeve të delegimit (funksione të deleguara) nga njësitë vendore të Qarkut Shkodër ka miratuar projekte dhe leje ndërtimi për :

Investime Publike

- Vendimi nr.1, datë 12.03.2008, Miratim projekti “Ndërtim ujës-jellësi”, në fshatin Juban, Komuna Gur i Zi, Shkodër.

- Vendimi nr.3, datë 11.04.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin “Godina e Komunës Blerim”, Komuna Blerim, Pukë.(Nuk është zbardhur leja e ndërtimit, sepse nuk janë paguar taksat në bazë të ligjit.Drejtoria e Urbanistikës ka njoftuar zyrtarisht Komunën Blerim).
- Vendimi nr.8, datë 07.07.2008, Miratim projekti për objektin “Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Mnelë e Madhe-Mnelë e Vogël”, Komuna Vig-Mnelë , Shkodër.
- Vendim nr.12, datë 07.07.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin “Sistemim oborri të Qendrës Komunitare Gur i Zi”, Komuna Gur i Zi, Shkodër.
- Vendimi nr.13, datë 07.07.2008, Miratim projekti për objektin “Rehabilitim i ujësjellësit Hajmel”, Komuna Hajmel, Shkodër.


Investime private

- Vendimi nr.1, datë 11.04.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin “Antenë AMC”, në fshatin Theth, Komuna Shalë, Shkodër.
- Vendimi nr.2, datë 11.04.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin “Antenë AMC”, në fshatin Drisht, Komuna Postribë, Shkodër.
- Vendimi nr.4, datë 11.04.2008, Miratim leje ndërtimi për objektin “Zdrukthtari, Qendra At Mhill Troshani”, në fshatin Theth, Komuna Qerret, Pukë.
- Vendimi nr.5, datë 11.04.2008, Miratim studimi urbanistik dhe leje shesh ndërtimi për objektin “Pulari”Vezë mode”, Komuna Kastrat, Malësi e Madhe.


Proçedura e miratimit të një leje ndërtimi është e ndarë në disa faza, faza e parë-miratimi i studimeve urbanistike pjesore, faza e dytë - miratimi i lejes për shesh ndërtimi, faza përfundimtare-miratimi i lejes së ndërtimit, për rrjedhojë ka shumë dosje që janë miratuar në fazën e parë dhe të dytë dhe janë në proçes plotësimi dokumentacioni për fazën e tretë.

2.3.2 Të ardhurat e realizuara nga taksa e lejeve të ndërtimit për vitin 2008


Të ardhurat e realizuara nga taksa e lejeve të ndërtimit për periudhën 1 Janar – 30 nëntor 2008 janë në




Raporti i të ardhurave të realizuara nga lejet e ndërtimit, viti 2007-2008



Raporti i të ardhurave të realizuara nga taksa e lejeve të ndërtimit, me taksat e tjera të



Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve, për vitin 2008



Raporti i tarifave të shërbimeve, viti 2007-

shumën 10 063 000 lekë, ndërsa në vitin 2007 janë realizuar në shumën 1 049 004 lekë

2.3.3. Miratimi i zonave informale në 6-mujorin e parë të vitit 2008

➤ Sektori i Urbanistikës Ligjore

Sektori i Urbanistikës Ligjore, ka shqyrtuar dokumentacionin ligjor për një sërë zonash informale në Qarkun Shkodër, të cilat i ka paraqitur për miratim në Këshillin e Qarkut Shkodër. Ndërkohë

ka pezulluar procedurat e miratimit për zonat informale në zona turistike dhe zona të mbrojtura , duke pasqyruar argumentimin ligjor për çdo rast.

➤ **Spektori i Projekteve**

Spektori i Projekteve ka shqyrtuar dokumentacionin e zonave informale nga ana teknike, lidhur me hartografinë, me specifikimet teknike, me përcaktimet e vijës së zonave turistike dhe zonave të mbrojtura.

2.3.4 Spektori i Projekteve

Spektori i Projekteve në përmbushje të detyrave funksionale, ka kontrolluar me përgjegjësi dokumentacionin në aspektin teknik dhe kadastral, gjithashtu ka shqyrtuar nga ana teknike detyrat e projektimit dhe studimet urbanistike.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, me komunat dhe bashkitë e qarkut Shkodër, ka hartuar 40 fish-projekte, në të cilat janë evidentuar prioritetet kryesore për rrugët rajonale dhe rrugët komunale të qarkut Shkodër, të cilat janë dorëzuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Janë hartuar projekt-preventivat për disa pika rreziku (të domosdoshme për ndërhyrje) të rrugës së Dukagjinit. Gjithashtu ky sektor ka hartuar ak-kontrollet përkatëse, në rastin e marrjeve të lejeve të ndërtimit nga subjektet privatë ose publikë, me marrjen e njoftimit zyrtar nga firma e ndërtimit dhe investitori, aktin e piketimit të objektit dhe më pas aktet për përfundimin e themeleve dhe të karabinasë sipas grafikut të realizimit të punimeve.

Në cilësinë e përfaqësimit në Drejtorinë e Prokurimit , ka hartuar dokumentacionin teknik të prokurimeve publike të realizuara në Këshillin e Qarkut.

Spektori i Projekteve në zbatim të urdhërave dhe detyrave javore me shkrim të Kryetarit të KQSH ka realizuar detyrat e mëposhtme:

- Drejtori i Urbanistikës, çdo javë ditën e hënë, në mbledhjen e mëngjezit ka informuar për punën e realizuar gjatë javës nga çdo sektor, si dhe ka paraqitur planin javor të veprimtarisë së Drejtorisë.
- Është përfunduar dokumentacioni teknik për tenderin e rievimit të Razmës, dhe Thethit në afatin e caktuar.
- Është zhvilluar sipas standarteve tema për gjendjen e infrastrukturës rrugore në Zonën e Dukagjinit, prezantuar në Konferencën “Dukagjini në Fokus”.

- Janë koordinuar veprimet me Bashkinë Shkodër dhe Komunën Bushat , për plotësimin e dokumentacionit sipas standarteve të kërkuara nga K.RR.T.R.SH. për Landfillin në Bushat.
- Është realizuar vlerësimi vjetor i performancës së punës, për çdo anëtar të stafit.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës Ligjore është realizuar dixhitalizimi i arshivës për lejet e ndërtimit të mitratuara në vitin 2007- 2008.
- Është përgatitur fishprojekti për të përfituar financimin e shtuar për tabelat turistike.
- Janë përcaktuar prioritetet për realizimin e studimeve urbanistike dhe rievimeve topografike për vitin 2009, duke përcaktuar vlerat përkatëse.

Spektori i Projekteve, detyra të parealizuara

- ✚ Nuk është organizuar takimi me Institutin e Studimeve Urbanistike Tiranë, për koordinimin e punës për realizimin e studimeve urbanistike. Ky është në proçes.

Spektori i Urbanistikës Ligjore

Veprimtaria e këtij sektori është fokusuar në kontrollin e të gjitha aspekteve ligjore të dokumentacionit, që shoqëron kërkesën për studime urbanistike, leje sheshi dhe leje ndërtimi. Gjithashtu në përmbushje të përgjegjësisve që ka ky sektor :

- Ka hartuar rregulloret e Këshillit Teknik dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Qarkut Shkodër, në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, për mirëfunksionimin e tyre.
- Ka ndjekur dhe kryer proçedurat përkatëse ligjore për lidhjen e akt-marrëveshjeve me njësitë vendore, që delegojnë kompetecën e planifikimit të territorit Këshillit të Qarkut.
- Ka dhënë konsulencë juridike përfaqësuesve të komunave dhe bashkive të Qarkut Shkodër, që kërkojnë ndihmë juridike në fushën e urbanistikës.
- Ka shqyrtuar nga ana ligjore të gjitha kërkesat, ankesat dhe shkresat, që vijnë në Drejtorinë e Urbanistikës, nga qytetarët dhe institucionet shtetërore, dhe i ka ndjekur sipas proçedurave ligjore.
- Ka studiuar strategjitë kombëtare, rajonale, dhe lokale në funksion të shqyrtimit dhe miratimit të planeve strategjike lokale të bashkive/komunave të Qarkut Shkodër, që kërkojnë miratimin e planeve strategjike nga KRRT-ja e Qarkut Shkodër.

- Ka dhënë mendime ligjore për draftet ligjore dhe nënligjore, që i drejtohen Këshillit të Qarkut dhe janë të lidhura me veprimtarinë e Drejtorisë së Urbanistikës, duke hartuar relacionet përkatëse.
- Ka siguruar Ndihmën Juridike për të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë së Urbanistikës, Këshillit Teknik dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Qarkut Shkodër.
- Ka përgatitur për miratim në Këshillin e Qarkut, projekt-akte ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjë me veprimtarinë e Drejtorisë së Urbanistikës.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Emergjencave specialisti i këtij sektori (ing.Gj.Gjergji) ka hartuar projekt-preventivat përkatëse, në rastet e rënies së zjarreve, rrëshqitjeve të dheut etj, pas verifikimit të dëmeve në vendin e ngjarjes.

Sektori i **Urbanistikës Ligjore** në zbatim të urdhërave dhe detyrave javore me shkrim të Kryetarit të KQSH ka ushtruar veprimtarinë në këto drejtime:

- Është zhvilluar sipas standarteve tema “Situata aktuale e pronësisë mbi tokën në Zonën e Dukagjinit , disa drejtime zhvillimi”, prezantuar në Konferencën “Dukagjini në fokus”.
- Janë zbatuar urdhërat dhe detyrat e Kryetarit, për përmbushjen me korrektësi dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie të kompetencave ligjore.
- Është paraqitur projekt-struktura e administratës së qarkut , në zbatim të detyrave të lëna.
- Është shqyrtuar dhe paraqitur për miratim Këshillit të Qarkut dokumentacioni i zonave informale.
- Është përgatitur shkresa drejtuar KRRTRSH dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI. Z.Shaban Memia , duke argumentuar nga ana ligjore, arsyet e mosmiratimit të disa zonave informale, që rezultojnë zona të mbrojtura.
- Janë dorëzuar me shkrim realizimi i punës mujore dhe është paraqitur plani i punës për muajin ardhshëm.
- Është organizuar mbledhja e Komisionit Juridik.
- Është studjuar “Plani Final Rajonal, Shkodër-Lezhë” , si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal., në zbatim të detyrave me shkrim të Kryetarit.

Sektori i Urbanistikës Ligjore, detyra të përealizuara.

- ✚ Organizimi i mbledhjeve të K.RR.T.-së nuk është kryer rregullisht çdo muaj, sipas detyrave të lëna nga Kryetari , për shkak të mungesës së dokumentacioni nga aplikuesit për leje ndërtimi. Në këto raste Sektori i Urbanistikës Ligjore ka kërkuar zyrtarisht plotësim dokumentacioni tekniko-ligjor dhe ka njoftuar Kryetarin e K.RR.T.-së për mangësitë e vërejtura.

Sektori i Projekteve dhe Sektori i Urbanistikës Ligjore përveç detyrave specifike realizojnë një sërë detyrash të përbashkëta, në shërbim të qytetarëve.

- Konfirmim harta pronësie
- Nxjerrje e dokumenteve arshivore.
- Realizimi i procedurave ligjore të lejeve të shfrytëzimit .
- Kryerja e aktkontrolleve të objekteve, pas miratimit të lejeve të ndërtimit.
- Informim dhe pajisje e subjekteve fizikë dhe juridikë me kërkesat ligjore dhe formularët përkatës të plotësimit të dokumentacionit, kur aplikojnë për miratim të sheshit të ndërtimit dhe për miratim të lejes së ndërtimit, si dhe për miratimin e lejes së shfrytëzimit.
- Realizimi i procedurave ligjore për leje shfrytëzimi.

2.3.7 Veprimtaria e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Qarkut

Duke qenë një strukturë e re pranë Këshillit të Qarkut Shkodër veprimtaria e INU ka pasur këto drejtime kryesore;

- Studimi dhe njohja e ligjeve dhe akteve nënligjore të reja “Për inspektimin e ndërtimit”, në funksion të implementimit të tyre në praktikë .
- Kryerja e korrespondencës zyrtare me Prefekturën dhe njësitë vendore të Qarkut Shkodër, për evidentimin e njësive vendore që nuk e kanë ngritur INU vendore në bazë të ligjit.
- Administrimi dhe ndjekja e procedurave ligjore për ankesat e bëra gjatë vitit 2008.
- Bashkëpunimi me Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, Dega Shkodër, me qëllim këmbimin e eksperiencave për realizimin e përgjegjësive dhe detyrimeve ligjore.
- Zbatimi i detyrave dhe urdhërave të Kryetarit për përmbushjen e kompetencave ligjore.

Aspekte pozitive në veprimtarinë e Drejtorisë së Urbanistikës.

- Kompetencat ekskluzive të KRRT-së Qarkut dhe Drejtorisë së Urbanistikës për dhënien e lejeve të ndërtimit për investime strategjike.
- Të ardhurat e realizuara nga taksat e lejeve të ndërtimit, krijojnë bazën financiare për realizimin e studimeve urbanistike në Qarkun Shkodër, dhe fonde për hartimin e planit rajonal sipas afateve që do të përcaktojë ligji i ri “Për planifikimin e territorit”.
- Realizimi i një sërë shërbimesh për qytetarët .
- Dixhitalizimi i arshivës.
- Një grup pune i specializuar në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe në fushën juridike ka krijuar premisa për përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave të shumta, që e karakterizojnë zyrën e urbanistikës.
- Miratimi i planeve strategjike të 6 njësisë vendore përbën një risi dhe mjaft e rëndësishme, jo vetëm për zhvillimin e njësisë vendore të Qarkut, por dhe për hartimin e politikave rajonale të Qarkut.
- Ngritja e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Qarkut, do të vendosë përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës.

Aspekte negative

- Numri i lejeve të dhëna është i kufizuar. Arsyet kryesore janë;
 1. Proçedurat e gjata ligjore për marrjen e një leje ndërtimi
 2. Mungesa e kontrollit efektiv ndaj territorit.
 3. Mentalitetit i gabuar i qytetarëve, se mbi pronën, sipas të cilës pronari mund të bëjë gjithçka me pronën e vet.
- Dhënia e lejeve të ndërtimit vetëm mbi bazën e studimeve urbanistike pjesore, për shkak të mungesës së planeve rregulluese dhe studimeve urbanistike, parimet kryesore për planifikimin e territorit.
- Mungesa e arkitektëve, urbanistëve, inxhinierëve elektrikë, të mjedisit etj, si rezultat edhe numrit të pakët të këtyre specialistëve në Shkodër.

Rezultate të Pritshme

- ✚ Ndryshimet e fundit të ligjit dhe akteve nënligjore, do të çojë në rritjen e kërkesave për leje ndërtimi si rezultat i proçedurave më të thjeshtuara për qytetarin


- ✚ Ngritja e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik dhe bashkëpunimi me komunat dhe bashkitë në drejtimi të kontrollit të territorit, duke zbatuar sanksionet ligjore do të krijojë premisa për ndalimin e ndërtimeve , ngrirjen e zhvillimeve në tokat bujqësore dhe zonat e mbrojtura.
- ✚ Të ardhurat nga lejet e ndërtimit do të rriten si rezultat i forcimit të kontrollit ndaj territorit dhe procedurave më të thjeshtuara për qytetarët, por kjo do të rezultojë në rritjen e ngarkesës së punës për Drejtorinë e Urbanistikës.
- ✚ Studimi i ligjeve dhe akteve nënligjore , në funksion të implementimit të tyre në praktikë, si dhe përkushtim dhe performancë e lartë e të gjithë stafit për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

2.4 DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, gjatë vitit 2008, ka punuar në drejtim të zbatimit të buxhetit të vitit 2008, në zbatim të kompetencave ligjore, Vendimeve të Këshillit të Qarkut Shkodër, planeve mujore, detyrave javore me shkrim të Kryetarit, duke synuar në:

- **Përdorimin me efektivitet të fondeve për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave .**
- **Sigurimin e një pjesëmarrje sa më të gjerë në vendimmarrje në lidhje me funksionet dhe kompetencat e ushtruara nga Këshilli i Qarkut Shkodër.**

Për këtë arsye Këshilli i Qarkut Shkodër , veprimtarinë dhe analizën e tij ekonomiko-financiare e ka ushtruar në këto drejtime kryesore.



2.4.1 DETYRAT E REALIZUARA NGA SEKTORI I BUXHETIT

Analiza e Buxhetit:

- **I - Menaxhimi i fondeve buxhetore për transfertën e pakushtëzuar**
A - Realizimi dhe përdorimi me efektivitet i të Ardhurave.
B - Realizimi i shpenzimeve në përputhje me planet buxhetore.
- **II - Analiza analitike e llogarive buxhetore**
A - Analiza e llogarive 600, 601, 602, 230 dhe 231 për K.Qarkut .
B - Analiza e realizimit të shpenzimeve të Nd/jes Rajonale të Rr.Rurale Shkodër.
- **III - Menaxhimi i fondeve të transfertës së kushtëzuar**
A - Analiza e shpenzimeve të realizuara.

Analiza financiare:

- **I- Rregjistrimi në Kontabilitet**
A - I Aktivëve të Qëndrueshme të Trupëzuara.
B - I materialeve dhe i shërbimeve.
C - I mjeteve monetare në bankë .

Analiza e Buxhetit:

Analiza e Buxhetit për Këshillin e Qarkut Shkodër do të bëhet në drejtimet e mëposhtme:

I - Menaxhimi i fondeve buxhetore

TË ARDHURAT:

A- Analiza e realizimit dhe përdorimit të të Ardhurave.


Të ardhurat për 11/Mujorin e vitit 2008 paraqiten si më poshtë;

- Të ardhura të trashëguara nga viti 2007	17.380 mijë lekë
- Të ardhura të realizuara gjatë vitit 2008	<u>20.494 “</u>
Gjithsej	37.874 “

Realizimi i të Ardhurave për Vitin 2008

Në mijë lekë

Nr.	Llojet e të Ardhurave	Plani	Realizimi	Rritje/Ulje
		2008	11/Mujor	%
1	Taksa e Qarkut e vitit 2007	2.180	1.020	47%
2	Taksa e Qarkut e vitit 2008	8.940	8.640	97%
3	Taksa e ndikimit ne infrastrukturë.	2.750	10.612	385%
4	Taksa te tjera dytësore	500	222	44.4%
	Të Ardhura Gjithsej	14.370	20.494	142.6%



1-Kontributi i Bashkive dhe Komunave për Këshillin e Qarkut për vitin 2007.

- ❖ Megjithë punën e vazhdueshme të Drejtorisë sonë lidhur me arkëtimin nga njësitë vendore e të ardhurës nga Taksa e Qarkut, taksë e cila zë rreth 80% e të ardhurave të përgjithshme të Këshillit të Qarkut, për zbatimin e Vendimeve të KQSH të viteve 2007 dhe 2008, shkresave të dërguara dhe kontaktve të herëpashershme, akoma nuk ka përfunduar arkëtimi i vitit 2007.

- ❖ Sipas Akt-Rakordimeve me Njësitë Vendore të Qarkut për vitin 2007, si dhe Akt – Marrëveshjeve të lidhura në mes të Njësive Vendore dhe Këshillit të Qarkut për vitin 2008, arkëtimi i Taksës së Qarkut të vitit 2007 paraqitet si më poshtë;

Arkëtuar Taksa e Qarkut e vitit 2007, në vitin 2008.

-Rethi Shkodër

1. Komuna Velipojë	390.125 lekë
2. Komuna Guri Zi	95.600 lekë
3. Komuna Dajç	72.000 lekë
4. Bashkia Vau-Dejës	66.000 lekë
5. Komuna Rrethina	211.700 leke
6. Komuna Pult	13.000 lekë
7. Komuna Temal	<u>119.400 lekë</u>
Shuma	967.825 lekë

-Rethi Pukë

1. Komuna Gjegjan	41.791 lekë
2. Komuna Qafë-Mali	<u>10.068 lekë</u>
Shuma	51.859 lekë

Të gjitha Njësitë Vendore të Rrethit Malësi e Madhe e kanë arkëtuar Taksën e Qarkut për vitin 2007.

Njesitë Vendore të Qarkut Shkodër, të cilat nuk e kanë arkëtuar Taksën e Qarkut për vitin 2007 ;

Rrethi Shkodër

1. Komuna Bushat
2. Bashkia Shkodër (Diferencë)

Rrethi Pukë

1. Bashkia Pukë
2. Bashkia Fushë Arrëz
3. Komuna Qelëz
4. Komuna Rrapë

Këto Njësi mbeten debitoare në shumat e mësipërmë ndaj K.Q.Shkodër, gjë e cila paraqitet dhe në bilancin përfundimtar të vitit 2007.

2-Taksa e Qarkut e vitit 2008.

Për vitin 2008, Taksa e Qarkut paraqitet si më poshtë;

Sipas shkresës së Ministrit të Financave mbi mënyrën e arkëtimit të kuotës së Qarqeve, janë hartuar Akt-marrëveshjet në mes të Kryetarit të K.Q.Shkodër Z.Gjovalin Kolombi dhe Kryetarëve të Njësiave Vendore të Qarkut tonë, duke vendosur shumën në vlerë absolute të taksës së Qarkut për vitin 2008 e cila llogaritej duke parashikuar të ardhurat që vetë Njësitë Vendore do të arkëtonin.

Janë lidhur Akt-Marrëveshjet me pothuajse të gjitha njësiat vendore të Qarkut tonë duke përjashtuar:

1. Komuna Bushat-Rrethi Shkoder
2. Bashkia Pukë - Rrethi Pukë
3. Bashkia Fushë Arrëz-Rrethi Pukë
4. Komuna Fierzë - Rrethi Pukë
5. Komuna Qafë Mali - Rrethi Pukë
6. Komuna Qerret - Rrethi Pukë
7. Komuna Qelëz - Rrethi Pukë
8. Komuna Rrape - Rrethi Pukë

Në zbatim të Akt-Marrëveshjeve të mësipërme janë arkëtuar të ardhurat nga Taksa e Qarkut e vitit 2008 shumat si më poshtë :

1. Bashkia Shkodër	7.000.00 leke
2. Komuna Ana Malit	30.000 leke
3. Bashkia Vau-Dejës	340.000 lekë
4. Komuna Velipojë	230.000 lekë
5. Komuna Guri Zi	75.000 lekë
6. Komuna Postribe	60.000 leke
7. Komuna Berdice	112.500 leke
8. Komuna Temal	35.000 lekë
9. Komuna Shllak	4.000 leke
10. Komuna Vig-Mnele	10.000 leke
11. Komuna Dajc	43.000 leke

12. Komuna Hajmel	37.500 leke
13. Komuna Rrethina	190.500 leke
14. Komuna Gjegjan	25.460 leke
15. Të gjitha Njsitë Vendore të Rrethit Malësi e Madhe ne shumën	lekë 447 .000 leke

Gjithsej të ardhura viti 2008 nga taksa e qarkut 8.639.960 leke.

Si përfundim, lidhur me këtë zë të Buxhetit të vitit 2008, të ardhurat e planifikuara të vitit 2008 ishin 8.940 mijë lekë, kurse arkëtimi i tyre 8.640 mijë lekë, ose 97 % e tyre.

Të ardhurat e mbetura nga viti 2007 për tu arkëtuar në vitin 2008 ishin 2.180 mijë lekë, aktualisht janë arkëtuar 1020 mijë lekë ose 47 % e tyre.

3- Të ardhurat nga lejet e ndërtimit;

Këto të ardhura në Buxhetin e vitit 2008, zënë 22.5 % të të ardhurave të përgjithshme. Këto ishin planifikuar 2.750 mijë lekë, por si rezultat i ndërtimit të veprave të mëdha në Qarkun e Shkodrës, dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre për marrjen e lejes së ndërtimit nga K.RR.T. e Qarkut Shkodër, si dhe punës së bërë nga Drejtoria e Urbanistikës janë arkëtuar në këtë zë 10.612 mijë lekë dhe ky zë është realizuar në masën 385 % .

4-Të ardhurat Dytësore;

Këto të ardhura zënë 2.5 % në Buxhetin e vitit 2008. Shuma e planifikuar është 500 mijë lekë, kurse janë realizuar 222 mijë lekë ose 44,4 % e tyre. Këto të ardhura përbëhen nga arkëtimet e tarifave të shërbimeve nga Sektori i Transportit dhe Emergjencës, si dhe nga Drejtoria e Urbanistikës.

Sa më sipër planifikimi i të ardhurave të përgjithshme sipas Buxhetit të vitit 2008 ka qenë 14.370 mijë lekë. Realizimi është bërë në masën 20.494 mijë lekë ,ose 142.6%. Në këtë rritje peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga lejet e ndërtimit.

SHPENZIMET

B -Realizimi i shpenzimeve buxhetore.

Shpenzimet e Këshillit të Qarkut ndahen në:

- Shpenzime për funksionet e veta.
- Shpenzime për funksione të deleguara.

Shpenzimet për funksionet e veta

Funksionet e Njesive të Qeverisjes Vendore dhe burimet e financimit të tyre përcaktohen në ligjin 8652 datë 31.07.2000”Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.


Funksionet e veta, përfaqsojnë funksionet që janë përgjegjësi ekskluzive e njësive të qeverisjes vendore. Financimi i tyre bëhet nga të ardhurat e vetë njësive të qeverisjes vendore dhe nga transfertat e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor. Në institucionin tonë këto të ardhura dhe transfertat e ministrisë mbulojnë shpenzimet për administratën e Këshillit të Qarkut, si dhe Nd/jen Rajonale të Rrugëve Rurale Shkodër.

Gjatë vitit 2008 nga **Këshilli i Qarkut Shkodër** janë realizuar **shpenzimet** për transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat si më poshtë;

Shpenzimet e realizuara sipas zërave gjate vitit 2008:

000/lekë

Emërtimi	Plani i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	Realizimi Në %
Paga	22.425	21.705	97%
Sigurime Shoqërore	5.500	4.278	78%
Shpenzime Operative	14.353	7.169	50%
Paga Keshilltarësh	8.694	8.366	96%
Transferime	4.421	1.015	23%
Stud.Projektme-Investime	24.093	6.555	27.2%
Fondi Rezerve	3.050	375	13%
Shuma	82.536	49.463	60%



a. **Shpenzime për paga, paga këshilltarësh dhe sigurime shoqërore** janë realizuar në zbatim të VKM- së nr. 551 datë 7.11.2002 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page e përcaktimin e kufijve të pagave te punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar me V.K.M. -në Nr. 355 datë 14.06.2006, me VKM -në Nr. 434 datë 13.07.2007, si dhe niveleve te miratuara me Vendimin e Këshillit te Qarkut Nr.1, datë 15.02.2008, ndryshuar me Vendimin e Këshillit te Qarkut Nr.24, datë 17.04.2008.

Këshilli i Qarkur ka miratuar shpërblimin mujor të këshilltarëve 10 % e pagës së Kryetarit të K.Q. Shkodër.

Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetsore nga punëdhënësi është përkatësisht 21,7% dhe nga punëmarrësi 11,2%.

- b. - Për realizimin e vlerës në "**Mallra e Shërbime**" prej 6352 mijë lekë është vepruar në zbatim të ligjit nr. 6942 date 25.12.84, VKM nr. 70 datë 11.03.85, si dhe të VKM nr.1, datë 10.01.2007" Për miratimin e rregullave te prokurimit publik " duke plotësuar kërkesat për funksionimin sa më eficient të aparatit të Këshillit të Qarkut.
- c. - Janë realizuar **investime** në shumën 4107 mijë lekë, ku përfshihen investimet për blerje pajisje për zyra nga të ardhurat e planifikuara, si dhe blerja e një autoveture. Kanë përfunduar dhe dy Rilevimet Topografike ne vlerën 2.448 mijë lekë.
- d. - Tek Transferimet janë përfshirë, pagesa për Shoq. e të Verbërve, për Shoqaten e Qarqeve si dhe pagesa per kuotën e antarësisë së Qarkut në Organizma Ndërkombëtare, të gjitha këto në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Qarkut gjate vitit 2008.

II - Analiza analitike e llogarive buxhetore.

A - Analiza e llogarive 600, 601,602, 230 dhe 231 për Këshillin e Qarkut .

Për të analizuar llogaritë buxhetore të vitit 2008 , planifikimin e tyre në Grand dhe të Ardhura si dhe faktin e realizimit të tyre paraqesim tabelën e mëposhtme:

Realizimi dhe planifikimi i shpenzimeve sipas artikujve buxhetor.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi buxhetor	Plan grandi	Plan të Ardhura	Realizimi	Realizimi Ne %
I	Qarku Shkodër-				
1.	Paga gjithsej Art 600	22.425	0	21.705	97%
2.	Sigurime shoqërore 601	5.500	0	4.278	78%
3.	Shpenz. Operative Art 602	21.747	1300	15.535	67%
4.	Investime Art 231	2.193	4900	4.107	58%
5.	Studim proj. Art 230	12000	5000	2.448	14.4%
6.	Trans. Trashëg. Art. 606	88	0	0	0
7.	Fondi rezervë Art 609	3.050	0	375	13%
8.	Transferime Art 604	0	4333	1.015	23.4%
	Gjithsej	67.003	15.533	49.463	60%

Për sa me sipër sqarojmë se;

Artikulli 600 "Paga" sipas Buxhetit të vitit 2008 është planifikuar vetem nga granti i buxhetit për vitin 2008 dhe është përdorur në masën 97%.

Art. 601 Sig. Shoq. është përdorur në masën 78%, dhe është planifikuar nga granti i vitit 2008.

Shpenzimet Operative , Art. 602, janë realizuar në masën 67 % .Mbajtja e këtyre shpenzimeve është bërë sipas planifikimit për çdo nënartikull dhe është bërë përdorimi me efikasitet i tyre.

Paraqitja në formë tabele e shpenzimeve operative, e ndarë kjo në artikuj dhe nënartikuj për Këshillin e Qarkut për vitin 2008 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Objekti i prokurimeve	Plani Vjetor	Fakti vjetor	Realizimi
				%
	MALLRA DHE SHERBIME TË TJERA			
1	6020100 Kancelari	400	363.	91%
2	6020200 Materiale pastrimi e ngrohje	250	92	37%
3	6020300 Mat për funks.paisj.zyrash	400	99	25%
4	6020500 Blerje dok.	200	81	40%

5	6020900 Furnizime materiale të tjera	300	131	44%
	Shuma	1550	766	49%
	MATERIALE E SHËRBIME SPECIALE			
2	6021007 Libra dhe publikime	100	65	65%
	6021099 Të tjera mat dhe shërb. speciale	400	0	0
	Shuma	500	65	13%
	SHERBIME			
1	6022001 Energji elektrike	350	290	83%
2	6022002 Ujë	150	0	0
3	6022003 Telefon dhe fax	800	711	89%
4	6022004 Posta	200	167	84%
5	6022005 Shërbime për ngrohje	100	100	100%
6	6022007 Komision bankare, të tjera	30	6	86%
7	6022008 Shërb të ruajtjes dhe sig.	1500	759	51%
8	6022010 Printime, publikime	250	220	88%
9	6022011 Kosto e Trajn.Sem.	100	0	0
10	6022099 Shërbime të tjera	70	0	0
	Shuma	3550	2253	63.5%
	SHPENZIME TRANSPORTI			
1	6023100 Karburant dhe vaj	1500	1062	71%
2	6023200 Pjesë këmbimi rrota + bateri	200	116	58%
3	6023300 Sigurac. mjete	600	157	26%
4	6023900 Shpenzime transporti	250	101	40%
	Shuma	2550	1436	56%
	MIRËMBAJTJE E ZAKONSHME			
1	6025300 Sh. Mirëmb.ndërtese	400	398	99.5%
2	6025400 Shp.mirëmbj.elekt.hidr.	300	76	25%
3	6025600 Sh. Mjete transp.	200	120	60%
4	6025800 Mat. zyre e të përgj.	200	2	1%
	Shuma	1100	597	53%
	SHPENZ .QERAMARRJE			
1	6026100. Qeramarrje	250	105	42%
	SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE			
1	6029001 shp. pritje e përcj.	400	107	27%
2	6029002 Aktivitete sociale	400	129	30%

3	6029004 Shp. Sig.Ndërt tj.	50	12	24%
4	6029005 Honorare + KRRT	1168	682	58%
5	6029006 Paga Këshilltarësh	8694	8366	96%
6	6029099 Të tjera	400	177	44%
7	6029007 Shpenz. për pjesëmarrje në konf.	400	0	0
	Shuma	11447	9473	83%
	DIETA			
1	6024100 Dieta brenda vendit	600	464	73%
2	6024200 Dieta jashtë vendi	1500	376	25%
	Shuma	2100	840	40%
	TOTALI LLOG 602	23047	15.535	67.4%

Investimet paraqiten si më poshtë:


000/lek

Nr.	Emërtimi i Investimeve	Plan	Realizimi	Realizimi në %
1	Paisje zyresh	400	243.22	61%
2	Paisje kompjuterike	400	391,69	98%
3	Kondicionerë	400	178	45%
4	Paisje teknike	400	0	0
5	Blerje automjeti	3300	3294	99.8%
	Gjithsej	4900	4106,91	83.8%

Studime dhe Projektme paraqiten si më poshtë

1000 lekë

Nr.	Emërtimi i Stud.Projektmeve	Plan	Realizimi	Realizimi në %
1	St.Proj. i Rrugës së Dukagjinit	12000	0	0
2	St.Urb. i zonës turistike Razem	2500	0	0
3	Azhorn. i gjendjes akt. Theth	1250	1.224	98%
4	Rilevim topogr. Razem	1250	1.224	98%
	Gjithsej	17000	2.448	14.4%



B- Analiza e realizimit të shpenzimeve të Nd/jes Rajonale të Rr.Rurale Shkodër.

Nr.	Emërtimi buxhetor	Plan Vjetor Grand Ardhura	Realizimi vjetor	Realizimi në %
I	ND/JA.R.M.RR.Rurale			
1.	Paga gjithsej Art. 600	38.200	38.019	99.5%
2.	Sigurime Shoqërore Art. 601	8.273	7.845	95%
3.	Shpenzime Operative Art.602	4.788	4.716	98.5%
4.	Investime Art. 231	1.250	1.132	91%
5.	Ndihmë e menjëhershme Art. 606	225	225	100%
6.	Gjithsej	52.736	51.937	98.5%

Gjate vitit 2008 në Nd/jen Rajonale të Rrugëve Rurale Shkodër është punuar, që me fondin e tyre të planifikuar të punohet me efektivitet per realizimin e detyrave të përcaktuara.

1.-Artikulli 600"Pagat" sipas Buxhetit të vitit 2008 është planifikuar nga granditë 33205 mijë lekë dhe 4992 mijë lekë janë bërë rritje autorizimi nga të ardhurat e Qarkut.

Art. 601 Sig. Shoq. është përdorur në masën 95 %.

Shpenzimet Operative , Art. 602, janë realizuar në masën 98.5 %. Mbajtja e këtyre shpenzimeve për çdo nën artikull është bërë sipas planifikimit dhe përdorimit me efikasitet të tyre.

Llogaria 602 për Nd/jen Rajonale të Rrugëve Rurale paraqitet si më poshtë:

Nr	Objekti i prokurimeve	Plani Vjetori	Fakti vjetor	Realizimi
				%
	MALLRA DHE SHERBIME TË TJERA			
1	6020100 Kancelari	58	58	100%
2	6020200 Materiale pastrimi e shërbimi	50	50	100%
	Shuma	108	108	100%
	MATERIALE E SHERBIME SPECIALE			
1	6021007 Libra dhe publikime	18	18	100%
2	6021001 Uniforma e Veshje	300	300	100%
3	6021005 Pajisje e Vegla pune	250	250	100%
	Shuma	568	568	100%
	SHERBIME			
1	6022004 Posta	8	8	100%
2	6022007 Komision bankare,të tjera	5	5	100%
	Shuma	13	13	100%
	SHPENZIME TRANSPORTI			
1	6023100 Karburant dhe vaj	1.600	1.597	99.8%
2	6023200 Pjese këmbimi rrota + bateri	360	358	99.4%
3	6023300 Sigurac. Mjeti	30	30	100%
4	6023900 Shpenzime transporti	255	247	96.8%
	Shuma	2.245	2.232	99.4%
	DIETA			
1	6024100 Dieta	500	500	100%
	Shuma	500	500	100%

	MIREMBAJTJE E ZAKONSHME			
2	6025400 Shp.mirëmbj.rrugëve. (Skorje)	475	475	100%
3	6025600 Shpenzime për riparim Ure (Vermosh).	479	479	100%
4	6025800 Shpenzime për riparim zyrash.	400	341	85.2%
	Shuma	1.354	1.295	95.6%
	TOTALI Llog 602	4.788	4.716	98.5%

Në Art. 231 ,

Shpenzime për riparimin “Mure mbajtës në Lotaj” me vlerë 1.250 mijë lekë, investim i realizuar gjatë vitit 2008 në Segmentin Shosh-Breg Lumi.

III - Menaxhimi i fondeve të transfertës së kushtëzuar.

A -Analiza e shpenzimeve të realizuara për funksionet e deleguara.

Funksionet e deleguara, janë përgjegjësi të pushtetit qendror të deleguara tek pushteti vendor.Financimi i këtyre funksioneve bëhet nga buxheti i shtetit (Transferta e kushtëzuar).

Në funksionet e deleguara për Qarkun e Shkodrës për vitin 2008 kemi :

- **Kadastra**
- **Sekretari i Deputetit**
- **Investim”SinjalistikeTuristike”**

Realizimi i shpenzimeve për **kadastrën** është si më poshtë: 000/lek

Nr.	Emertimi i shpenz.	Plan	Fakt	Realizimi
1	Paga art.600	3678	3513	95.5%
2	Sig.shoq. Art.601	753	723	96%
3	Shp.Operative	349	272	78%
	Gjithsej	4780	4508	94.3%

Kadastra realizon edhe të ardhura, të cilat derdhen te gjitha në buxhetin e shtetit.Kështu për vitin 2008 ajo ka realizuar **522 mijë lekë** të ardhura.

Realizimi i shpenzimeve për **Sekretarin e Deputetit** është si më poshtë:

Nr.	Emertimi i shpenz.	Plan	Fakt	Realizimi
1	Paga art.600	385	140	36%
2	Sig.shoq. Art.601	84	30	36%
3	Shp.Operative	29	16	55%
	Gjithsej	498	186	37.3%

Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e mungesës së nr. të punonjësve, që në muajin prill 2008.

- **Investime-Sinjalistikë Turistike:**

Me fondin e akorduar nga Ministria e Kultures Rinisë dhe Sporteve në shumën 2.000.000 lekë është realizuar investime për "Sinjalistikë Turistike" në Qarkun e Shkodrës në vlerë absolute lekë 1.979.578 ose 99 %.

2.4.2 DETYRAT E REALIZUARA NGA SEKTORI I FINANCËS

Analiza financiare:

- **I- Rregjistrimi në Kontabilitet**

A - I Aktivëve të Qëndrueshme të Trupëzuara.

B - I materialeve dhe i shërbimeve.

C - I mjeteve monetare në bankë .

I- Rregjistrimi në kontabilitet dhe evidencat

Në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Financës çdo ditë rregjistron në mënyrë kronologjike veprimet kontabël ditore. Veprimet mbahen të regjistruara në librat përkatës të kontabilitetit, libri i shpenzimeve, pagave, bankës dhe magazinës. Çdo fund muaji bëhet kuadrimi i librave të kontabilitetit dhe në veçanti ai i magazinës, në bazë të veprimeve hyrje, dalje te kryera gjatë muajit.

Është realizuar dhe mbajtja në mënyrë dyfishe e librit të magazinës si nga magazina ashtu dhe nga Sektori i Financës, ku kryhet dhe kontroll i vazhdueshëm për të ditur gjendjen reale të magazinës në çdo moment.

Është hartuar Bilanci i periudhës 9/ mujore të vitit 2008.

Ka filluar puna për inventarizimin e pasurisë së Qarkut, si për Aktivet e Qëndrueshme të

Trupëzuara dhe për Inventarin e Imët dhe do të përfundojë në fund të muajit.

Azhornohet në çdo fund muaji libri i pagave të punonjësve .


Brënda datës 5 të cdo muaji përgatiten evidencat e shpenzimeve, të ardhurave dhe të investimeve, pas rakordimeve të bëra me Degën e Thesarit dhe dërgohen në instancat shtetërore , që i kërkojnë të dhënat, në ministri, Prefekturë etj.

Pas përfundimit të Akt-Rakordimit mujor me Degën e Thesarit për të ardhurat, në fillim të çdo muaji, bëhet rakordimi me drejtoritë që krijojnë të ardhura për shumat e arkëtuara të të ardhurave gjatë muajit.

2.5 Drejtoria e Shërbimeve

Drejtoria e Shërbimeve, duke menaxhuar dhe koordinuar punët në të gjithë sektorët, ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore, planeve mujore, detyrave javore me shkrim të ngarkuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, duke synuar;

- ✚ Kritjen e cilësisë së shërbimeve, duke shfrytëzuar me efektivitet burimet egzistuese.
- ✚ Monitorimin e veprimtarisë së çdo sektori.
- ✚ Përgjegjshmëri në zbatimin e kompetencave ligjore dhe kryerjen e detyrave.



2.5.1 Veprimtaria e Sektorit të Transportit, Emergjencave Civile dhe Nd/jes Rajonale të Rrugëve Rurale.

1. Miratimi i linjave të ardhura nga bashkitë dhe komunat.

Gjatë vitit 2008 janë miratuar orare shtesë për linjën rrethqytetase Shkodër-Vau Dejës-Shkodër, oraret shtesë për linjën ndërqytetase brenda qarkut Shkodër-Koplik. Janë miratuar lejet e transportit për udhëtarët dhe mallrat si më poshtë:

Janë lëshuar 1 çertifikatë transport udhëtarësh për subjekt juridik për linjën Pukë-Shkodër-Pukë; 2 Çertifikata transport udhëtarësh për subjektin subjekte juridike ne linjat Koplik-Shkodër-Koplik; 1 Liçencë transport mallrash për të tretë dhe me qira për subjektin juridik 3 Çertifikata transport udhëtarësh 1 Liçencë dhe 8 çertifikata transport mallrash për të tretë dhe me qira 1 Liçencë dhe 6 çertifikata transport mallrash për të tretë dhe me qira

2. Emergjenca:

Gjatë vitit 2008 pasi janë verifikuar dokumentacionet për 10 raste emergjencash civile të ndodhura nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, të mbështetura këto në ligj dhe vendime të Këshillit të Ministrave (të ligjit Nr. 8756 datë, 26/03/2001 "*Për Emergjencat Civile*"; V. K. M Nr. 206 datë 26/03/1998 "*Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish*"; V.K.M Nr. 664, datë 18/12/2002; V. K. M Nr. 655 datë 18/12/2000 si dhe V.K.M Nr. 708 datë 21/12/2000) janë dërguar në prefekturë për procedim të mëtejshëm. Këto raste janë për bashkinë Shkodër e Koplik; komunat; Dajç, Gruemirë, Qaf-Mali, Rrethina, Postrinë, Shkrel (12 raste). Krahas kësaj janë shqyrtuar dhe kthyer për plotësim dokumentacioni 10 raste .

3. Menaxhimi dhe koordinimi i punës me Nd/jen Rajonale të Mirëmbajtjes së Rr.Rurale.

Meqenëse drejtoria jonë ka në varësi edhe Ndërmarrjen Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, kemi mbajtur kontakt të vazhdueshëm me këtë ndërmarrje për të gjitha problemet që i kanë dalë, si dhe për nevojat emergjente që ka pasur kjo ndërmarrje për fonde në periudha të caktuara të vitit. Në bashkëpunim me këtë ndërmarrje është bërë vëzhgimi i rrugëve më problematike të qarkut tonë. Në përgjithësi puna e kësaj nd/je gjatë këtij viti ka ecur mirë, janë shfrytëzuar me efikasitet të plotë mjetet e pakta (mekanika dhe mjetet financiare) që kjo nd/je ka në dispozicion, si dhe mjetet financiare të caktuara nga ana e Këshillit të Qarkut. Fuqia punëtore është kontrolluar më mirë si në lidhje me zbatimin e planit të punës, ashtu dhe me disiplinën në punë të punonjësve. Orientimet kryesore të Kryesisë së Qarkut mbi të cilat dhe ne si drejtori jemi mbështetur, kanë qenë ; vëmendja kryesore të përqëndrohet në akset më problematike, pra aty ku rruga paraqet probleme serioze, idhur me pikat e rrezikut.(dëmtimi i

urave, mureve mbajtës, tombinove etj.) Në mbështetje të kësaj porosie ne kemi orientuar vazhdimisht këtë nd/je, që puna të përqëndrohet në këto akse problematike, që për mendimin tonë ashtu dhe të specialistëve të nd/jes kanë qenë dhe janë problematike :

1. Për sektorin e Shkodrës:

Në aksin: -Ura e Mesit-Prekal-Guri Mathesh-Pog-Kir-Mali i Shoshit me gjatësi 44 km.

Në aksin: -Mali Shoshit-Ura Lotaj-Breg lumi-Ndrejaj-Theth me gjatësi 36 km.

- Në këto 2 akse punojnë 32 punonjës, afërsisht sipas orientimit të Ministrisë përkatëse, ku një punonjës të ketë në patronazh 2 deri në 2,5 km. rrugë në mirëmbajtje. Për vetë terrenin e vështirë dhe mungesën e ndërhyrjeve me fonde në këtë rrugë, rruga ka mjaft probleme të cilat janë evidentuar, janë nxjerrë pikat e rrezikut, si dhe janë hartuar projektet e preventivat për ato ndërhyrje që janë më të domosdoshme.

- Akset e tjera për Shkodrën nuk paraqesin shumë probleme meqenëse kanë terren pothuaj fushor e kodrinor, aksi i Shllakut vjen i dyti si kategori rruge, por dhe këtu si rezultat i ndihmës së dhënë nga të tretët rruga nuk paraqet probleme serioze.

Rrezikshmëri paraqet Ura e Skarrama-së në aksin Vau i Dejës -Krajin, gjë të cilën e kemi bërë disa herë problem deri në Kryeministri, por deri tani nuk është marrë asnjë masë konkrete. Kemi informacione që në këtë aks do të ndërhyjë së shpejti me fonde Qeveria nëpërmjet FSHZH, për të bërë të mundur lidhjen e këtij aksi të rrethit tonë me rrethin e Lezhës nga fusha e Zadrimës (Hajmel-Nenshat-Fishtë-Kallmet-Lezhë).

Për të shmangur situatat e papritura, (meqenëse kjo urë edhe mund të shembet sipas mendimit të specialistëve ekspertë të kësaj fushe), kemi lajmeruar dhe policinë rrugore dhe e kemi bllokuar urën duke vendosur grumbuj zhavorri e çakulli, por gjithashtu sipas informacioneve që ne kemi kjo rrugë është zhbllokuar përsëri.

Gjatë vitit 2008 rrugët nuk janë bllokuar (asnjë aks) qoftë dhe një ditë të vetme, kjo falë punës së mirë të kësaj nd/je dhe drejtorit të saj z.Gjovalin Kodra, si dhe përgjegjësive të sektorëve Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Është përdorur metoda e grupimit të forcave dhe mjeteve dhe është ndërhyrë në pikat më të rrezikshme duke u marrë me eliminimin e inerteve dhe grumbullimeve të tjera.

2.Për Sektorin e Malesisë së Madhe

Puna e nd/jes është përqëndruar në Aksin Tamarë -Vermosh, aks me gjatësi 36 km. Sipas verifikimit të bërë dhe rikonjksionit që tashmë e njohim prej disa vitesh në këtë rrugë, ka disa

pika rreziku, veçanërisht duke hyrë në Vermosh, pasi deri në Qafë të Bordolecit problemet janë më të vogla. Kemi evidentuar rreth 4-5 pika rreziku të cilat janë :

- Një urë në qendër të fshatit Vermosh e cila ka nevojë për rikonstrukcion.
- Riparimi i shpatullave të urës tjetër në fshat
- Zëvendësimi i tombinos në hyrje të Vermoshit
- Rikonstrukcioni i shpatullave të urës dhe prita me mure gabion,si dhe më kryesorja 2 mure

mbajtës,që duhet të ndërtohen në kthesën për tek Dogana .

Edhe kjo rrugë nuk është bllokuar asnjë herë gjatë këtij viti, megjithëse nuk kanë munguar reshjet e dëborës.

3.Për Sektorin e Pukës:

Është punuar mjaft mirë, pasi si rreth më larg nga qendra (Qarku) mjaft punë i kanë zgjidhur me iniciativën e tyre dhe me mjetet e të tretëve. Për këtë një punë të mirë ka bërë përgjegjësi i këtij sektori Z.Ded Qafa.

Edhe këtu rrugët janë të gjitha të kalueshme e nuk paraqesin shumë probleme, por ka nevoja për ndërhyrje dhe ne kemi evidentuar rreth 7-8 pika të rrezikshme kalimi, siç janë 2 urat në Degëzimin e Krrabit, 2 urat në aksin rrugor Tuç-Qafë Bari Minierë, një murë mbajtës tek përroi i Gështenjës etj.

Me drejtorinë e nd/jes janë mbajtur lidhje të vazhdueshme, gjithashtu kemi pasur ndihmën e vazhdueshme edhe të Kryetarit të Këshillit të Qarkut z.Gjovalin Kolombi, i cili ka shkëlur dhe verifikuar akset rrugore më problematike dhe më të vështira, duke bërë dhe sugjerimet e tij, që të paraqesim një relacion për ndërhyrjet që mund të bëhen nëpërmjet fondeve të këshillit të qarkut për vitin 2009. Për këtë u përcaktuan prioritetet, u hartuan projektet dhe preventivat dhe u miratuan në mbledhjen e Këshillit të Qarkut Shkodër me Vendimin Nr 57, dt.05.11.2008.

Prioritetet më të rëndësishme për të ndërhyrë, gjatë vitit 2009 :

1. Përforcim i shpatullave të urës në Stupen e Madhe Mali i Shoshit
2. Mure mbajtës në segmentin rrugor Dukagjin km 57.
3. Mure mbajtës tek Përroi i Ceverrit, aksi Dukagjin.

4. Mure mbajtës në vendin e quajtur Rrenimi km.5,2 Aksi Dukagjin.
5. 2 Mure mbajtës përballë kataraktit në zonën turistike Theth.
6. Rikonstruksion i dy urave në aksin e degëzimit të Krrabit në Fushë Arrëz.
7. Rikonstr. i mureve mbajtës në degëzim Miniera e Tuçit-Qafë Bari.
8. Rikonstruksion i urës në qendër të fshatit Vermosh.
9. Mure mbajtës e mbrojtës në degëzim të doganës Gerçar-Aksi Vermosh.
10. Zëvendësim tombino fshati Vermosh
11. Rikonstruksion i shpatullave të urës dhe soletë e saj në hyrje Vermosh.

Ndërhyrjet e realizuara për mirëmbajtjen e rrugëve për vitin 2008

Po kështu nga ana e nd/jes, mbështetur dhe në ndihmesën e Këshillit të Qarkut, por dhe me ndihmën e Ndërmarrjes te Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale janë kryer gjatë këtij viti këto ndërhyrje:

1. Me dt. 26,27 dhe 28 shkurt 2008 është bërë grupimi i forcave dhe mjeteve dhe është rehabilituar aksi nr.7 Hajmeli.
2. Me dt. 04 dhe 05 Mars 2008, jane grupuar te gjitha mjetet dhe 3 grupe pune për rehabilitimin e aksit nr.10 të M.Madhe, aksi Lapidar Vrakë -Gruemirë Qendër.
3. Në fillim të marsit 2008 është kryer prokurimi i naftës për mjetet motorrike, traktorët dhe makinat.
4. Është bërë konfirmimi i dokumentacionit të administratës.
5. Është hartuar një raport i shkurtër mbi veprimtarinë e Nd/jes Rajonale në bashkpunim me Agjensinë e Zhvillimit të Zonave Malore.
6. Aksion për riparimin e urës së trenit në fshatin Bardhaj dt.9.05.2008 dhe 02.06.2008 takim me administratën për vlerësimin e punës së gjithësecilit.

7. Është bërë përgatitja e dokumentacionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të disa makinerive.
8. Me dt.24,25,dhe 26 Qershor është bërë grupimi i forcave dhe i mjeteve për të rehabilituar aksin rrugor Mes-Kir-Breg Lumit-Theth.
9. Është bërë aksion me forcat e mjetet për riparimin e disa pjesëve të aksit rrugor Tamarë – Vermosh me dt.-01,02,03 Korrik 2008.
10. Është bërë prokurimi i rikonstruksionit për murin mbajtës në Lotaj ,Komuna Shalë me dt.18 Korrik 2008.
11. Është bërë riparimi i një shpatulle ure në fshatin Vermosh.
12. Me dt.10,11,12 Shtator 2008 është bërë e mundur ndërhyrja me rreth 50% të punonjësve të nd/jes dhe me të gjitha mjetet që ka ndërmarrja në dispozicion, si dhe me ndihmën e famulltarit të asaj zone i cili na dha fadromën e kishës për rehabilitimin e aksit rrugor te Shllakut.
13. Është bërë riparimi i zyrave të nd/jes.
14. Është bërë harta e re me akset rrugore.
15. Me dt.17,18,19 Nëntor, Aksion në aksin Nr.2 Mes –Prekal.
16. Janë bërë ndërhyrje dhe në akset e tjera rrugore.
17. Është bërë në Muajin tetor rehabilitimi i rrugës nga asfalti tek varrezat e qytetit

2.5.3 Sektori i Shërbimeve Sociale,Arsimit dhe Shëndetësisë

Sektori i Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë gjatë vitit 2008, ka ushtruar veprimtarinë e tij sipas detyrave funksionale në fushën e shërbimeve sociale, të investimeve të arsimit dhe shëndetsisë.

Në fushën e Shërbimeve Sociale

- Ka grumbulluar dhe përpunuar statistikat 4-mujore për “Grupet shoqërore në rrisht” të Njësisve Vendore të Qarkut Shkodër dhe kanë rezultuar këto *probleme*:

- *Nuk respektohen afatet ligjore proceduriale në dorëzimin e të dhënave nga disa njesi vendore.*
- *Njësitë vendore nuk kanë krijuar strukturat përkatëse për të identifikuar të dhënat .*
- Ka grumbulluar dhe përpunuar statistikat për “familjet në nevojë” të Qarkut Shkodër dhe, në bashkëpunim me OJF “The Door” në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit të kësaj organizatë me K.Q. Shkodër, është realizuar shpërndarja e pakove të ndihmave familjeve në nevojë të Komunave Shalë, Shosh, Pult dhe Shoqatës të Verbërve.
- Është ngritur Komiteti i Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve.
- Ka kontaktuar me punonjësit socialë në bashki, komuna, institucione publike e private të shërbimeve sociale, për shkëmbimin e përvojave dhe për realizimin e çështjeve me interes të përbashkët.
- Ka marrë pjesë në takime pune, me përfaqesues të Njësive Vendore të Qarkut Shkodër, të OJF-ve, të institucioneve publike të arsimit, rendit, institucioneve publike e private të shërbimeve sociale, për çështje të ndryshme sociale.
- Ka marrë pjesë në grupin e punës të ngritur në kuadër të projektit të “Luftës kundër Dhunës në Familje”, ku janë diskutuar mënyrat për ngritjen e një rrjeti për trajtimin e rasteve konkrete të dhunës në familje.
- Ka marrë pjesë aktive në takimet e zhvilluar në kuadër të projektit të GTZ për Personat me Aftësi të Kufizuar, projekt i cili është në vazhdim.
- Ka mbështetur dhe krijuar kushtet e bashkëpunimit për realizimin e projektit “Kam të drejtë të jetoj me të drejta” të Qendrës “Fëmijë sot”, për fëmijët e ngujuar të qarkut Shkodër, të cilëve u janë shpërndarë pako me libra dhe është organizuar një trajnim dy ditor me mësuesit, që u japin mësim fëmijëve të ngujuar.
- Ka bashkëpunuar në organizimin e Konferencës “ Dukagjini në fokus”, si dhe ka ofruar informacion për përgatitjen e temës “Dinamika e Popullsisë, Arsimit dhe Kulturës dhe mundësitë e zhvillimit, në Dukagjin”.
- Sipas detyrës së lënë, janë hartuar tre Fish Projekte në fushën e Arsimit, Kulturës dhe Shërbimeve Sociale, të cilat mund të realizohen nëpërmjet Cross Border Cooperation në kuadër të IPA CBC.

Në fushën e Arsimit:

- Ka ndjekur shpërndarjen e investimeve të vitit 2008 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, nga fondi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për Grantet Konkurruese, duke bërë edhe analizën e nivelit të thithjes së investimeve e koeficientët krahasues ndër vite.
- Ka ndjekur realizimin e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, duke tërhequr periodikisht evidencën e degëve të thesarit në Shkodër, Pukë dhe Malësi të Madhe.
- Në kuadër të Programit CARDS, ka marrë pjesë në Grupin e Punës në nivel qarku, për Projektin “Mbështetje për reformën në Arsim dhe Formim Profesional” dhe duke u mbështetur në draftin “Propozimn Skemë Pilot për decentralizimin e AFP”, paraqitur nga Qarku Durrës, me nismë të Kryetarit të Qarkut Shkodër z.Gjovalin Kolombi dhe me mbështetjen e CARDS, u ngrit një grup pune me specialistë të fushës për hartimin e këtij drafti për Qarkun Shkodër.

Me datë 25.11.08 u zhvillua takimi i dytë për AFP, ku u prezantua Drafti dhe Statuti “Propozim Skemë Pilot për decentralizimin e AFP” në Qarkun Shkodër.

❖ **Realizimet e investimeve për vitin 2007 nga grantet konkurruese në Arsim për Qarkun Shkodër, janë si më poshtë:**

- Nga investimet e fituara nga grantet konkurruese në Arsim për vitin 2007, nuk janë realizuar objektet:

- Riparim palestër, Shkolla 9 vjeçare “Branko Kadia”
- Rikonstruksion Shkolla e Mesme “Ndre Mjeda”

- Nga totali prej 781.131mijë lekë të granteve konkurruese të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës,

a) Qarku Shkodër ka fituar 86.336 mijë lekë, 11% te fondit total,

b) Nga 34-njësi vendore të qarkut, kanë përfituar vetëm 8-njësi vendore

Investimet për vitin 2008 në Arsim

Objekti dhe Njësia Vendore	Vlera	Investitori
Ndërtim i ri, Shkolla 9 vjeçare Trush, Shkodër	33023	Granti
Ndërt. Shk 9-vj. Fsh. Shtoj i Vjetër	21223	Granti

Rikonstruksion . shk 9-vjecare, Drisht	4000	Granti
Supervizim Rik. dhe palestër, Shkolla 9-vjeçare B.Kadia, Shkodër	250	TA
Supervizim Ndërtim i ri, Shkolla 9 vjeçare Trush, Komuna Berdicë, Shkodër	450	TA
Supervizim Nd.Shk. 9-vjeçare, fshati Velipojë e Re-Sektor, Komuna Velipojë, Shkodër	250	TA
Supervizim Nd. Shk 9-vj. Fsh. Shtoi Vjeter , 12 klasa, Komuna Rrethina,Shkodër	300	TA
Pajisje, Shkolla 9 vjeçare B.Kadia,Shkodër	5000	TA
Pajisje Shkolla 9 vjeçare "Ndre Mjeda", Shkodër	3000	TA
Pajisje, Shkolla 9 vjeçare Vig, Komuna Vig Mnelë, Shkodër	1000	TA
Pajisje, Shk.9-vj. fshati Stajkë, Komuna Bushat Shkodër	1000	TA
Pajisje, Shkolla 9 vjeçare Trush Komuna Berdice Shkoder	3500	TA
Pajisje.Shk. 9-vjec fshati Velipoje e re- Sektor komuna Velipoj Shkoder	2000	TA
Pajisje Shk 9-vj. Fsh. Shtoi Vjeter , 12 klasa Komuna Rrethina Shkoder	2000	TA
Pajisje. Shk 9-vj. Drisht , 8 klasa Komuna Postribe Shkoder	1600	TA
Ndertimi i shkolles 9 vjecare qytet, Shkoder	20000	TA
Pajisje shkolla 9 vjecare qytet, Shkoder	2400	TA
Studim Projektme per shkollat, Bashkia Shkoder	3200	TA
Meremetim objektsh shkollore	3500	TA
Rikonstruksion, shk. e mesme Gj.Huaja "Sh.Juka", Shkoder	33800	TA
Rikonstruksion, Shk. e Mesme Artistike "P.Jakova", Shkodër	25000	TA
Ndërtimi i shkollës se mesme profesionale, Shkodër, Qeveria Austriake - TVSH	30000	TA&Qev Austriake
Shkolla e Mesme K.Margjinaj Shkodër - TVSH Projekti CARDS	500	Ta&Cards

Blerje pajisje, shk. e mesme Gj.Huaja "Sh.Juka", Shkodër	3000	TA
Blerje pajisje, Shk. e mesme Artistike "P.Jakova", Shkodër	3500	TA
Pajisje, shkolla mesme qytet Shkodër	2400	TA
Totali	205,896	

Në fushën e Shëndetsisë

- Ka ndjekur shpërndarjen e investimeve të vitit 2008 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, nga fondi i Ministrisë së Shëndetsisë për Grantet Konkruuese, duke bërë edhe analizën e nivelit të thithjes së investimeve e koeficientët krahasues ndër vite.
- Ka ndjekur zbatimin e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, duke tërhequr periodikisht evidencën e degëve të thesarit në Shkodër, Pukë dhe Malësi të Madhe.
- Ka ndjekur problemet e paraqitura pranë Sektorit nga të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut të Shkodrës, për nevojën e ndërhyrjeve emergjente në ambientet shëndetsore për vitin 2008.

Realizimet e investimeve për vitin 2007 nga grantet konkurruese në Shëndetësi për Qarkun Shkodër, janë si më poshtë:

- Nga totali prej 800.000 mijë lekë të granteve konkurruese të Ministrisë së Shëndetsisë,
 - a) Qarku Shkodër, ka përfituar 90.750 mijë lek ose 11,3% të fondit total,
 - b) Ka përfituar 56.650 mijë lek më shumë se në vitin 2006, ose 2.6 herë më shumë, në 20-njësi vendore dhe përkatsisht:
- Janë realizuar të gjitha investimet e fituara nga grantet konkurruese në Shëndetësi, përveç investimit për :


- ndërtim ambulance A1, me vlerë 1.500.000 lekë në fshatin Shllak, Komuna Shllak,
- ndërtim ambulance Tip.A1, fshati Palvar me vlere 1.500.000 leke. Komuna Qendër.

Investimet për vitin 2008 në Shëndetësi

1. Shtesë kati në godinën e Drejtorisë së Shëndetësisë Publik, Qarku Shkodër, me një fond prej 21.200.000 lekë të reja, të akorduara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Sipas shkresës nr. 107 prot. datë 06.05.2008 të drejtorisë së Shëndetit Publik M.Madhe për vitin 2008 nuk janë akorduar fonde për investime në këtë Drejtori.

2.6 DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE TEKNIKES INFORMATIKE

Kjo drejtori ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore, Vendimeve të Këshillit të Qarkut Shkodër, planeve mujore, detyrave me shkrim të lëna nga Kryetari , për realizimin e detyrave të çdo sektori, si dhe për sigurimin e disiplinës në punë të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër.



Për përdorimin sa më të mirë të potencialeve njerëzore i është dhënë përparësi;

- Menaxhimit të administratës me anë të objektivave dhe detyrave javore të mirëpërcaktuara për çdo sektor nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

- Vlerësimet të performancës të çdo punonjësi, nëpunësi civil, në bazë të qëllimit të punës, objektivave të punës.
- Ka shqyrtuar, analizuar dhe ndjekur kriteret e pranimit të specialistëve në aparatin e Këshillit të Qarkut, në përputhje me kërkesat e secilit vend pune, llojin e specialitetit, eksperiencës dhe vjetërsisë në punë, niveli i arsimimit, etj .
- Ka përgatitur, ndjekur dhe verifikuar rregullat e përgjithshme të veprimtarisë së punonjësve të Aparatit, të kriterëve për zbatimin e disiplinës në punë.
- Ka hartuar planifikimin e fondeve për shpenzimet buxhetore të aparatit të Këshillit të Qarkut, dhe në bazë të planit të buxhetit të miratuar, ka evidentuar realizimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore.
- Ka organizuar, ndjekur dhe administruar shërbimin e autoveturave për të mbuluar nevojat e institucionit, sektorëve dhe punonjësve.
- Ka siguruar bazën materiale për administratën e K. Q. Shkodër me kancelari dhe pajisje të ndryshme. Ka organizuar dhe kryer furnizimin materialo – teknik të aparatit të Këshillit.
- Ka përgatitur dhe plotësuar dokumentacionin për inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
- Ka ruajtur dhe administruar dosjet e personelit të Aparatit të Këshillit të Qarkut.
- Ka shumëfishuar materialet për mbledhje Kryesie dhe Këshilli.
- Ka ndjekur dhe zbatuar rregullat për furnizimin e karburantit, etj.
- Ka mbikëqyrur magazinën.

Në vitin 2008 është miratuar struktura e Këshillit të Qarkut Shkodër me VKQ nr.24, datë 17.04.2008, strukturë e hartuar në bazë të ligjit, e cila ka në përmbajtjen e saj klasat “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, duke ndrequr parregullsitë e strukturës së mëparshme. Ky aspekt pozitiv është evidentuar në Projekt-Raportin e Komisionit të Shërbimit Civil “Për Mbikqyrjen e Menaxhimit të Shërbimit Civil në Këshillin e Qarkut Shkodër”.

2.6.2 Sektori i Teknikës Informatike

- Ka mirëmbajtur nga ana fizike dhe virtuale çdo kompjuter të Këshillit të Qarkut.
- Ka mirëmbajtur dhe administruar rrjetin kompjuterik të Këshillit të Qarkut.
- Ka mirëmbajtur dhe administruar shërbimin e internetit në institucion.
- Ka instaluar dhe mirëmbajtur të gjithë programet gjithnjë e më të fundit në kompjuterat e Këshillit të Qarkut.

- Ka marrë pjesë në blerjet e reja të pajisjeve kompjuterike, që janë bërë në institucion ku ka bërë sugjerimet e veta.
- Ka modifikuar, mirëmbajtur dhe azhornuar me materiale faqen ëeb të Qarkut me adresë përkatësisht ëëë.qarkushkoder.org.
- Janë përkthyer materialet e faqes së internetit në anglisht për të pasuruar pjesën anglisht të saj.
- Ka formatuar të gjithë prezantimet në PoëerPoint për Konferencën “Dukagjini ne fokus”.

2.6.3 Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun

Në mbështetje të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, akteve ligjore dhe nënligjore, Sektori Juridik pranë K.Q.Shkodër gjatë vitit 2008 ka ushtruar veprimtarinë në këto drejtime kryesore:

- Ka siguruar ndihmën juridike për të gjithë veprimtarinë e Këshillit , Kryetarit, Kryesisë dhe Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër .
- Ka hartuar dhe sigluar aktet e nxjerra nga Kryetari i K. Qarkut, nga Këshilli i Qarkut , nga Kryesia e Këshillit të Qarkut në zbatim të akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore.
- Ka studiuar, përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Qarkut, projekt-akte ligjore dhe nënligjore, që janë kompetencë e Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit.
- Ka bashkërenduar dhe ndihmuar administratën për përgatitjen e projektvendimeve.
- Ka hartuar dhe përgatitur nga pikëpamja juridike kontratat dhe marrëveshjet që lidh Këshilli i Qarkut me persona fizik (emërimet në punë) apo juridik .
- Ka drejtuar punën e njohjes së legjislacionit të ri me punonjësit dhe specialistët e tjerë të administratës së Këshillit Qarkut, si dhe njohjen me VKM-të që kanë të bëjnë me komunat e bashkitë e Qarkut Shkodër.
- Ka ndjekur marrëdhëniet juridike midis Qarkut, Bashkisë, Komunave dhe Prefekturës së Qarkut Shkodër si dhe me pushtetin Qendror.
- Ka dhënë konsulencë juridike përfaqësuesve të komunave dhe bashkive te Qarkut tonë dhe shtetasve, që kanë nevojë për konsulencë juridike.
- Ka siguruar ndihmën juridike për të gjitha shkresat që dalin nga drejtoritë e tjera të Këshillit të Qarkut Shkodër.

- Ka përfaqësuar Këshillin e Qarkut Shkodër në bashkëpunim me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës në të gjitha instancat gjyqësore, kur ky ishte palë e paditur ose paditës duke ndjekur çështjen me përgjegjësi në të gjitha shkallët e gjyqimit.
- Çështje gjyqësore të tjera gjatë vitit 2008 nuk ka patur.
- Ka përgatitur materialet në bashkëpunim me SAMT dhe IMT dhe ka marr pjesë në mbledhjet e Komisionit të Mbrojtjes Tokës.
- Ka hapur dhe plotësuar Dosjet për shpalljen e dëshmorëve të atdheut dhe për marrjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” në mbështetje të ligjit nr 8607 datë 27.04.2000”Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” dhe VKM 151 datë 25.04.2002, të shoqëruara me relacionin projekt vendimin dhe vendimin përkatës.
- Ka përgatitur propozimet për pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve që i drejtohen Këshillit të Ministrave, të cilat merren me vendim të Këshillit të Qarkut duke hartuar relacionet, projekt vendimet dhe vendimet përkatëse sipas VKM nr.429 datë 12.9.2002.
- Ka përgatitur vendimet e Kryetarit të Qarkut për pezullimin e lejeve të qarkullimit me kërkesën e Komisarariatit të Policisë Rrugore sipas ligjit nr. 8378 datë 22.7/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” , Udhëzimit të përbashkët nr.1128/1 Prot. datë 05.03.2004 të Ministrisë Rendit Publik dhe nr.1616 datë 6.03.2004 i M.P.V dhe Decentralizimit.
- Azhurnimi i faqes zyrtare të Këshillit të Qarkut me ligjet, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe vendimet e Këshillit të Qarkut 2008.

Zyra e Protokoll-Arshivës

- Ka pranuar, regjistruar dhe shpërndarë në institucion korrespondencën zyrtare.
- Ka administruar dhe sistemuar arshivën e K. Q. Shkodër në mbështetje të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë” .
- Ka pranuar dhe administruar mandat – pagesat për Urbanistikën dhe Kadastrën.
- Gjithsej në Këshillin e Qarkut janë 1080 shkresa për vitin 2008, kanë hyrë 810 shkresa, 669 janë shkresa me kthim përgjigje, 141 janë për dijeni.(jo me përgjigje), ndërsa 270 shkresa jane evidenca, kërkesa për çelje fondi , dërgime njoftim kontrate e rritje autorizimi.

2.7 DREJTORIA E PROKURIMEVE

Prokurimet e realizuara pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2008

Drejtoria e Prokurimeve ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore , objektivave, respektimit të afateve ligjore, planeve mujore, detyrave javore të ngarkuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër duke synuar;

- ❖ Zbatimin me korrektësi të ligjeve dhe akteve nënligjore për prokurimet publike.
- ❖ Përkushtim dhe ndërgjegje të lartë në realizimin e procedurave të prokurimit.
- ❖ Nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.
- ❖ Besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Prokurimet publike të realizuara për vitin 2008

Shërbim i ruajtjes me roje private.

Fondi limit: 1 250 000 (Një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Qëllimi i kësaj kontrate ishte ruajtja dhe sigurimi i ambienteve të godinës së K.Q.Shkodër dhe të zyrës së Informacionit Turistik në Shirokë, jetës dhe sigurisë së personelit të K.Q.Shkodër.

Data e zhvillimit të tenderit: 26.02.2008

Vlera e shpallur fituese: 1 138 800 (një milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH ose 1 366 560 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë dhjetë)Lekë me TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Vojvoda shrsf

Kohëzgjatja e kontratës: 01.04.2008 deri me 01.04.2009

Gjendja aktuale: Firma vazhdon rregullisht ruajtjen e objektit, me roje me tre turne, dhe likuidimi bëhet në fund të cdo muaji me anë të faturës.

Blerje autoveture

Fondi limit: 2 750 000 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Qëllimi: Blerje autoveture për nevojat e K.Q.Shkodër

Data e zhvillimit të tenderit: 07.05.2008

Vlera e shpallur fituese : 2 745 000 (dymilion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa TVSH, ose 3 294 000 (tremilion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë me TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Porsche Albania shpk

Kohëzgjatja e kontratës: 17.06.2008

Gjendja aktuale: Makina është marrë në dorëzim, dhe janë kryer të gjitha pagesat përkatëse, gjithashtu është plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm i makinës.

Karburant dhe vaj

Fondi limit: 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Qëllimi i kësaj kontrate ishte furnizimi i automjeteve të K.Q.Shkodër me karburant dhe vaj.

Data e zhvillimit të tenderit: 14.05.2008

Vlera e shpallur fituese : 1 247 573 (një milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 1 497 088 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatëdhjetë e tetë lekë) lekë me TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Albdrin shpk

Kohëzgjatja e kontratës: 26.06.2008 deri me 31.12.2008

Gjendja aktuale: Furnizimi kryhet sipas nevojave të institucionit, dhe shoqërohet me faturën përkatëse, gjithashtu çmimi pëson ndryshime të vazhdueshme sipas çmimit të tregut.

Sinjalistika Turistike

Fondi limit: 1 666 666.7 (një milion e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë mijë, e gjashtë qind e gjashtë dhjetë e gjashtë pikë shtatë) leke pa TVSH

Qëllimi: Të vendosen tabela orientuese në pika të ndryshme turistike të qarkut të Shkodrës.

Data e zhvillimit të tenderit: 08.07.2008

Vlera e shpallur fituese: 1 649 648 (një milion gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Kontakt sh.p.k

Kohëzgjatja e kontratës: 19.08.2008, kontrata duhet të përfundonte me datë 19.09.2008, por është shty afati dhe ka përfunduar me datë 23.10.2008

Gjendja aktuale: Të gjitha tabelat janë vendosur, po rregullohen disa tabela të vendosura gabim, dhe po vazhdohet me procedurat e mëtejshme të marrjes në dorëzim të tabelave dhe përfundimin e procedurave, gjithashtu me anë të faturës do të bëhen dhe likuidimet përkatëse.

Rilevim topografik, azhurnim i gjendjes aktuale, Theth

Fondi limit: 1 041 666 (një milion e dyzetënjë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Qëllimi: Rilevim topografik i zonës turistike të Thethit

Data e zhvillimit të tenderit: 01.07.2008

Vlera e shpallur fituese : 1 020 000 (një milion e njëzet mijë) Lekë pa TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Poseidon XXL shpk

Kohëzgjatja e kontratës: 28.08.2008 deri me 28.10.2008

Gjendja aktuale: Rilevimet janë përfunduar dhe do të dorëzohen së shpejti.

✚ Rilevim topografik,Razëm

Fondi limit: 1 041 666 (një milion e dyzetënjëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Qëllimi: Rilevim topografik i zonës turistike të Razmës

Data e zhvillimit të tenderit: 01.07.2008

Vlera e shpallur fituese : 1 020 000 (një milion e njëzet mijë) Lekë pa TVSH

Operatori ekonomik i shpallur fitues: Poseidon XXL shpk

Kohëzgjatja e kontratës: 28.08.2008 deri me 28.10.2008

Gjendja aktuale: Rilevimet janë përfunduar dhe do të dorëzohen së shpejti.

✚ Realizimi i Blerjeve me Vlerë të Vogël.

Gjithashtu gjatë gjithë vitit kjo drejtori ka ndjekur prokurimet me vlerë të vogël, duke plotësuar nevojat, të çdo lloj natyre, të administratës së K.Q.Shkodër, gjithashtu ka hartuar dokumentacionin përkatës për likuidimin e të gjitha faturave përkatëse, në lidhje me këto prokurime.


Konkluzione

Bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, *Drejtoria e Prokurimeve*, ka realizuar prokurimet publike me transparencë dhe ndërgjegje të lartë, duke nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Drejtoria e Prokurimeve Publike ka pasur vështirësi në lidhje me gjetjen e operatorëve ekonomikë, që kanë dokumentacion të rregullt ligjor dhe që përmbushin me korrektësi detyrimet ligjore për pagimin e taksave. Evazioni fiskal ka krijuar probleme dhe vështirësi, veçanërisht në realizimin prokurimeve me vlerë të vogël.

2.8 Veprimtaria e Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për vitin 2008.

Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, pranë Këshillit të Qarkut është krijuar Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave.



2.8.1 Detyrat e realizuara nga S.A.M.T. për vitin 2008

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore, duke koordinuar punën me zyrat e inspektorëve në Rrethin Pukë dhe Malësi e Madhe, si dhe me komunitet dhe bashkitë e qarkut, duke realizuar me përgjegjësi detyrat dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Drejtimet kryesore të punës për vitin 2008 janë:

- Koordinimi i punëve të zyrës qendrore në Shkodër së bashku me ato të Pukës dhe M.Madhe në lidhje me të gjitha vërtetimet dhe detyrat që ka SAMT-ja
- Konfirmimi i të gjitha vërtetimeve të pronësisë të dërguara nga Z.RR.P.P. (28)
- Konfirmim të vërtetimeve të dërguara nga A.K.K.Pronave.(64)

- Konfirmim i vërtetimeve të pronësisë të lëshuara nga organet e pushtetit vendor për Zyrën e Punës mbështetur në VKM nr. 223 datë 19/04/2006 “Për pagesën e së ardhurës nga papunesia”.(217)
- Konfirmim i vërtetimeve të pronësisë të lëshuara nga organet e pushtetit vendor për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. (133)
- Konfirmimi i hartave të pronësisë. (226)
- Korespondenca zyrtare e shkresave që vijnë nga institucione shtetërore, komunat, bashkitë, si dhe qytetarët, duke shqyrtuar me përgjegjësi çdo kërkesë apo ankesë dhe duke kthyer përgjigje brenda afateve ligjore.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë, për organizimin e dy mbledhjeve të Komisionit të Ndarjes së Tokës në Qark.
- Verifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit (vertetim) për bonitetin e tokave për leje ndërtimi. (19)
- Vërtetime pronësie për A.K.K.Pronave. (349)
- Konfirmim skica dhe harta për A.K.K.P.
- Konfirmim i vërtetimeve sipas formularit nr.6.
- Përgatitja dhe dërgimi i nje kopje të formularit nr 6 për të gjithë rrethin e Shkodrës pranë Z.Q.RR.P.P Tiranë.
- Përgatitje dhe dërgim i të dhënave me zyrat e tokave në Pukë dhe M. e Madhe.
- Korespondenca, si dhe përgjigje me Drejtorinë e Menaxhimit Tokave, pranë Ministrisë së Bujqësisë.
- Asistuar në seancat e Gjykatës Shkallës Parë ,të Rrethit Gjyqësor Shkodër me cilësinë e palës tretë. (41 seanca gjyqësore)
- Pritje popullit dhe lëshim konfirmime për dokumenta ambasade dhe burse brenda dhe jashte vendit.

REKOMANDIM

❖ Për një mbarëvajtje më të mirë e më të shpejtë në kryerjen e shërbimeve, është e domosdoshme rritja e numrit të punonjësve në tre-katër specialistë, kushte më të mira pune në zyrë, plotësimi me pajisje gjeodezike-elektronike, mjete për të lëvizur në komuna dhe në dy zyrat tona në Pukë e Malësi të Madhe.

2.8.2 Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës

Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës ka punuar në drejtim të zbatimit të kompetencave ligjore, planeve mujore, detyrave me shkrim të ngarkuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, duke koordinuar punën me zyrat e mbrojtjes së tokës në komunat dhe bashkitë e qarkut, duke realizuar me përgjegjësi detyrat e mëposhtme:

- Ka punuar për krijimin e Regjistrit të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore.
- Ka mbajtur korespondenca dokumentacioni dhe kryer takime me ISHMT pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me komunat e Qarkut Shkodër, si dhe me Drejtoritë e Ndërmarrjeve të Institucioneve, që me ligjet përkatëse janë të detyruara të bashkëpunojnë në mbrojtjen e tokës bujqësore, për të përmbushur rolin, funksionet dhe detyrat ligjore. Ka ushtruar kontrole metodike dhe operative pranë komunave të Qarkut tonë ku janë mbajtur akt kontrollet dhe janë lënë detyrat përkatëse sipas rastit.

Është kontrolluar e mbajtur akt kontrolli për:

- **Komuna Dajç**

Në muajt Dhjetor 2007 – Janar 2008 janë kryer kontrole për humbjet e tokës për shkak të erozionit nga lumi Buna. Nga verifikimi dhe të dhënat e marra nga komuna vitet e fundit llogaritet të kenë humbur rreth 6 ha tokë bujqësore. Zona më e rrezikuar ka qenë ajo e fshatit Shirq, me një gjatësi rreth 1,2 km përgjatë rrjedhjes së lumit. Është ndërtuar një brez mbrojtës në një gjatësi prej 680 m, që nuk përfshin gjithë gjatësinë e zonës së rrezikuar. Në zbatim të masave që duhet të merreshin për mbrojtjen e tokës bujqësore, duhej të vijohej me pjesën e mbetur të ndërtimit të brezit mbrojtës.

Në fshatin Mushan në periudhën Korrik-Gusht 2008 në bashkëpunim me Inspektoriatin e Ndërtimit dhe strukturat e tjera të komunës, janë realizuar kontrole për dëmtimin e tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje. Pas verifikimeve u mbajtën proces verbalet e konstatimit të dëmtimit të tokës dhe u morën masa administrative, vendosje gjobe për 3 (tre) raste në shumën me vlerë 50 mijë lekë.

- **Komuna Qendër e Malësisë së Madhe**

Në fshatrat Kamicë e Palvar, në periudhën Janar-Shkurt 2008 janë kryer kontrole për humbjet e tokës bujqësore nga vërshimet e Përroit të Thatë, që kishte krijuar

depozitime në një shtresë prej 60 cm në një sipërfaqe prej rreth 11 ha të zhavorit. Për parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm u kërkua që nga ana e komunës të ndërhyhet dhe të merren masat e nevojshme për ndalimin e mëtejshëm të këtyre dëmtimeve sa më shpejt që të ishte e mundur.

- **Komuna Bushat**

Në fshatrat Stajkë, Kosmaç, Në periudhën Janar- Shkurt 2008 janë realizuar kontrole në bregun e Lumit Drin. Nga verifikimi në vend i gjendjes rezultoi se kishte dëmtime të argjinaturës mbrojtëse, të cilat mund të rezultonin me pasoja për dëmtimin e tokave bujqësore në rast të rritjes së ujrave të lumit. Në fshatin Stajkë u konstatua kontaminim i zonës me pesticide. Këto lëndë kimike janë hedhur nga subjekte të paidentifikuar nga komuna. Strukturave të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore iu kërkua të merreshin masa për riparimin e dëmtimeve të argjinaturës ekzistuese, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Mjedisit të realizojë neutralizimin e mbetjeve kimike në fshatin Stajkë.

Në muajt Gusht-Shtator 2008 së bashku me përfaqësuesit e ngarkuar nga komuna Bushat përgjegjesi i ZMT, inspektori i Zyrës së Urbanistikës dhe policia komunare, u verifikua gjendja e ndërtimeve pa leje në gjithë gjatësinë e aksit të rrugës nacionale, ku u konstatuan dëmtime të tokës bujqësore nga ndërtime të ndryshme. Për secilin nga objektet e kontrolluara u kërkua informacion nga ana e komunës për të mundësuar përcaktimin e objekteve pa leje. Nga ana e komunës morëm informacion jo të plotë dhe jo zyrtar.

- **Komuna Bërdicë**

Në fshatin Bërdicë e Sipërme, nisur nga një kërkesë për ndërhyrje të banorëve të fshatit u realizuan në muajin Shkurt 2008 akte kontrolli për dëmtimin e tokës bujqësore nga gërryerjet e Lumit Drin. U konstatuan gërryerje në fillimet e tyre me rrezikun e dëmtimeve të mëtejshme në një gjatësi prej rreth 500 ml. Për parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme u kërkua që nga komuna Bërdicë të merren masa të menjëhershme.

- **Komuna Ana e Malit**

Nga gërryerjet e Lumit Buna në një sipërfaqe prej rreth 20 ha tokë bujqësore, si rezultat i zgjerimit të shtratit të tij, në muajt Shkurt- Mars 2008, u verifikua në prani dhe të përgjegjësit të ZMT së komunës, dëmtimi i tokës bujqësore në fshatin Oblikë. Duke parë rrezikun e dëmtimeve të mëtejshme iu kërkua komunës marrja e masave urgjente për mbrojtjen e saj.

- **Komuna Guri i Zi**

Në muajin Maj, në fshatin Kuç, pas kontrollit në terren u konstatua se në brigjet e lumit Kir në pjesën jugore të tij kishte një dëmtim toke prej 6 ha dhe me gjendjen që paraqet, dëmtimi vazhdon lehtësisht. Ky akt kontroll iu dërgua komunës ku i sugjerohej marrja e masave përkatëse.

- **Komuna Postrisë**

Në fshatin Mes, u realizua gjatë muajit shkurt një akt kontrolli, ku u konstatua dëmtimi i 1,5 ha tokë bujqësore në brigjet e Lumit Kir. Ky akt kontrolli iu relatua komunës dhe iu kërkua marrja e masave mbrojtëse.

- **Komuna Kastriot**

Gjatë muajit Mars në fshatin Bajzë u verifikua gjendja e mbeturinave dhe kimikatëve në magazinat e stacionit të trenit Bajzë, meqenëse kishim informacion për kontaminim të zonave përreth, në prani dhe të punonjësve të stacionit, ku rezultoi që gjendja ishte në përmirësim e sipër.

- **Bashkia Koplak**

Gjatë muajit Maj është kontaktuar me punonjësit e ZMT pranë Bashkisë, për problemet që ato kanë me pikat e inerteve në zonën e tyre. U kontrollua njëra prej tyre që rezultoi me dokumenta të rregullta pranë zyrës së tyre.

Gjatë gjithë periudhës kohore është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me të gjitha komunat e bashkitë e qarkut dhe po punohet për të realizuar një bashkëpunim sa më efektiv me to për mbarëvajtjen e punës. Është bashkëpunuar me drejtuesit e njësive vendore dhe specialistët e ZMT në komuna, për parandalimin e dëmtimeve të tokës bujqësore nga faktorë të ndryshëm dhe është kërkuar vendosja në efikasitet e fondit për mbrojtjen e tokës, me qëllim mbrojtjen nga dëmtimet e ndryshme, si dhe ndërtimin e veprave antierozive, kulluese, etj.

IMT ka verifikuar e dokumentuar me proces verbale dokumentacionin përkatës hartografik dëmtimet e shkaktuara nga gërryerjet në brigjet e lumenjve kryesorë Drini, Buna, Kiri, Përroi i Thatë e disa përrenj të tjerë si Përroi i Banushit, Rrjollit etj., (në zonat më të dëmtuara prej tyre). Duke parë që fondet për mbrojtjen nga gërryerjet e lumenjve nuk kanë qënë të mjaftueshme, është diskutuar dhe në mbledhjet e ndryshme të KMT për të gjetur mënyrat e zgjidhjes së këtyre problemeve sipas rastit. Për rastet e konstatimeve të dëmtuesve të tokës bujqësore janë mbajtur proces verbalet dhe janë bërë procedimet përkatëse.

Ka organizuar përgatitjen e dokumentacionit (Relacion dhe P/vendim) për mbledhjet e Komisionit të Mbrojtjes së Tokës për qarkun Shkodër. Komisioni i Mbrojtjes së Tokës ka realizuar mbledhjet e tij sipas afateve ligjore çdo tremujor bazuar në ligjin nr. 9244 datë 17.06.2004, ku janë marrë dhe vendimet përkatëse.

Më shumë punë duhet të ishte bërë në drejtim të kontrolleve e takimeve direkte në terren, kjo për arsye të bashkëpunimit jo në nivelin e duhur me strukturat përkatëse të Z.M.T. në Komuna. Lë për të dëshiruar pjesëmarrja dhe raportimi nga komunat/bashkitë për detyrat e tyre në zbatim të ligjit. Problem mbetet krijimi i fondit për mbrojtjen e tokës prej të paktën 40 % mbi taksën e tokës bujqësore nga ana e komunave dhe bashkive të qarkut tonë, gjë që ka bërë mungesën e investimeve totale prej tyre në drejtim të mbrojtjes së tokës bujqësore. Gjithashtu problem mbetet ngritja reale e strukturave të mbrojtjes së tokës bujqësore në komuna dhe bashki. Duke pasur parasysh dëmtimet e tokave bujqësore nga gërryerjet e lumenjve e përrenjve, të konstatuara dhe nga IMT në terren, rezulton që fondet e akorduara nga qeveria janë të pamjaftueshme.

